



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 17

Tiranë – E enjte, 14 shkurt 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 2/2019 datë 31.1.2019	Për një ndryshim në ligjin nr. 8668, datë 23.10.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar..... 581
Ligj nr. 3/2019 datë 31.1.2019	Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr. 40/2012..... 581
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe i ministrit të Mbrojtjes nr. 9714/3, datë 11.1.2019	Për procedurat e kalimit të automjeteve dhe motomjeteve nga mjediset e drejtorive vendore të Policisë së Shtetit dhe ato të Policisë Kufitare dhe Migracionit, te drejtoritë rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit..... 583
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 2, datë 6.2.2019	Për zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor 2019..... 584
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 28, datë 30.1.2019	Për shpalljen e ndryshimeve të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 2 “Paraqitja e pasqyrave financiare” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 9 ‘Kombinimet e bizneseve dhe konsolidimi’, të përmirësuar”..... 585
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 21, datë 31.1.2019	Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit..... 590
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 32, datë 5.2.2019	Për delegimin e kompetencave..... 591
Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave nr. 85, datë 8.2.2019	Për delegim kompetencash..... 591

Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.2.2019	Mbi miratimin e vendimit për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.....	592
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 9, datë 6.2.2019	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë financiare shtesë nga Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a.....	596
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 17, datë 6.2.2019	Për dhënien e miratimit paraprak për zotërimin nga Balfin sh.p.k. të 88.95 për qind të kapitalit aksionar të Bankës Tirana sh.a.....	596
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 9, datë 24.1.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Kontratës për sigurimin e shërbimeve të balancimit(kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektro-energetik për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019” midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.....	597
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 10, datë 24.1.2019	Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 113, datë 8.7.2016.....	599
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 13, datë 31.1.2019	Mbi licencimin e shoqërisë RTS sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik, me fuqi të instaluar 2 mw, në fshatin Tren, Bilisht të rrethit Korçë.....	605
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 14, datë 31. 1.2019	Mbi shqyrtimin e Planit të Investimeve për vitin 2018 dhe Planit 10-vjeçar 2018–2027 të Zhvillimit të Rrjetit të shoqërisë ALBGAS sh.a..	607
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 15, datë 31.1.2019	Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror të Trans Adriatic Pipeline AG Albania, e regjistruar pranë QKB-së, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), Trans Adriatic Pipeline AG.....	609
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Sali (Mikel) Spahiu.....	613

**LIGJ**
Nr. 2/2019**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.**
8668, DATË 23.10.2000, “PËR PAJISJEN
E SHTETASVE SHQIPTARË ME
PASAPORTË PËR JASHTË SHTETIT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 8668, datë 23.10.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar, neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11**Ripajisja me pasaportë biometrike e shtetasve**

1. Shtetasi ripajiset me pasaportë biometrike:

a) në rastet e përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji;

b) kur pasaportës i ka mbaruar afati i vlefshmërisë;

c) 6 muaj përpara mbarimit të afatit të vlefshmërisë, kur udhëton apo qëndron përkohësisht në shtete që kushtëzojnë hyrjen ose qëndrimin me afatin 6-mujor të vlefshmërisë së pasaportës.

2. Procedura për ripajisjen me pasaportë biometrike të zakonshme dhe dokumentacioni që paraqitet përcaktohen me udhëzim të ministrit të Brendshëm.”.

Neni 2**Nxjerrja e akteve nënligjore**

Ngarkohet ministri i Brendshëm që, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë udhëzimin në zbatim të nenit 1 të këtij ligji.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 31.1.2019.

Shpallur me dekretin nr. 11075, datë 11.2.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Ilir Meta

LIGJ
Nr. 3/2019**PËR RATIFIKIMIN E**
LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE
TË MARRËVESHJES SË HUAS
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
(IBRD) PËR FINANCIMIN SHITESË TË
PROJEKTIT “SIGURIA E DIGAVE”,
TË RATIFIKUAR ME LIGJIN
NR. 40/2012

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet letërmarrëveshja ndryshuese e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin shitesë të projektit “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr. 40/2012, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 31.1.2019.

Shpallur me dekretin nr. 11076, datë 11.2.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Ilir

**Meta**

BANKA BOTËRORE
IBRD-IDA/GRUPI I BANKËS BOTËRORE

ZYRA E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE
Praterstrasse 31/21
Vienna, Austria, 1020

LINDA VAN GELDER

Drejtori rajonal, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe i Azisë Qendrore

15 qershor, 2018

Sh. së tij, Arben Ahmetaj

Ministër

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

SHQIPËRI

I nderuar z. Ministër,

Shqipëria: Programi i Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore - Projekti i Sigurisë së Digave

(Huaja nr. 8111 - ALB)

(Ripërcaktimi dhe shtyrja e datës së mbylljes)

Ne i referohemi: a) Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”) (“Marrëveshja e Huasë”); dhe b) Marrëveshja e Projektit ndërmjet Bankës dhe Korporatës Energjetike Shqiptare (“KESH”) (“Marrëveshja e Projektit”), e ndryshuar që sot, të dyja të datës 17 shkurt 2012, për Projektin e lartpërmendur.

Marrëveshja e Huas është modifikuar si më poshtë:

1. Skeduli 2, seksioni IV. A2: (Tërheqja e shumës së Huas)

Tabela sipas këtij seksioni është modifikuar për të rialokuar shumat brenda kategorive ekzistuese siç pasqyrohet në shtojcën e kësaj shkrese.

2. Seksioni IV.B.2: Data e Mbylljes është shtyrë deri më 31 dhjetor 2020.

I juaji shumë singërisht,

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Linda Van Gelder

Drejtori rajonal, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe i Azisë Qendrore

Tel.; +43 (1) 2170 782

Faks; +43 (1) 2170 701

Sh. së tij, Arben Ahmetaj

15 qershor, 2018



SHTOJCA
TËRHEQJA E SHUMËS SË HUAS

Kategoria	Shuma e kredisë së përcaktuar (shprehur në EURO)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen
1. Mallrat dhe punimet	15,461,250	100 %
2. Shërbimet e konsulentëve të zhvillimit të hidrocentraleve dhe menaxhimit të ujit për pjesët 2.1 dhe 2.4 të Projektit	0	100 %
3. Tarifa e paguar paraprakisht	38,750	Shuma e pagueshme sipas seksionit 2.03 të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me seksionin 2.07 (b) të Kushteve të përgjithshme
4. E papërcaktuar	0	
SHUMA TOTALE	15,500,00	

Tel. +43 (1) 2170 782

Faks: +43 (1) 2170 701

UDHËZIM I PËRBASHKËT**Nr. 9714/3, datë 11.1.2019**

**PËR PROCEDURAT E KALIMIT TË
AUTOMJETEVE DHE MOTOMJETEVE
NGA MJEDISËT E DREJTORIVE
VENDORE TË POLICISË SË SHETITIT
DHE ATO TË POLICISË KUFITARE DHE
MIGRACIONIT, TE DREJTORITË
RAJONALE TË REZERVAVE
MATERIALE TË SHETITIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”; neneve 2, 4/“c”, 6, 10 dhe 11, të ligjit nr. 9900, datë 10.4.2008, “Për rezervat materiale të shtetit”, si dhe pikave 2/“b” dhe 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 5.8.2008, “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, të ndryshuar, me qëllim që të ketë unifikim në procedurat që ndiqen për administrimin e automjeteve dhe të motomjeteve që kalojnë në Rezervat Materiale të Shtetit si pasojë e konfiskimit,

UDHËZOJMË:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave

Materiale të Shtetit është përgjegjëse për marrjen e masave të nevojshme për pranimin dhe marrjen në dorëzim të automjeteve dhe motomjeteve që kalojnë në Rezervat Materiale të Shtetit si pasojë e konfiskimit.

2. Mjetet e konfiskuara nga Policia do të pranohen dhe do të merren në dorëzim së bashku me dosjen respektive të secilit mjet, përgatitur nga Policia sipas rregullave të caktuara për këtë qëllim, pranë ambienteve të drejtorisë rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit që korrespondon me territorin përkatës, me procesverbal për secilin mjet, të nënshkruar respektivisht nga përfaqësuesit e Policisë dhe të Rezervave Materiale të Shtetit.

3. Dosja e mjetit që do të kalojë në Rezervat Materiale të Shtetit, duhet të përmbajë:

- a) procesverbalin e konstatimit të shkeljes;
- b) vendimin e organit administrativ për gjykimin e shkeljes (në rast se ka);
- c) njoftimet e kundërvajtësit dhe solidarit (në rast se ka) për masat administrative në ngarkim të tij;
- ç) vendimin e organit administrativ shtetëror për konfiskimin e mjetit dhe që autorizon komisaratin rajonal të Policisë Rugore Tiranë ose në sektorin e Policisë Rugore të qarkut, për kalimin e mjetit dhe të dosjes në Rezervat Materiale të Shtetit (bëjnë përjashtim mjetet e ndaluara në zbatim të nenit 203 të Kodit Rugor);



d) detyrimet financiare që i detyrohet kundërvajtësi shërbimit të Policisë Rrugore, deri në ditën kur mjeti kalon/dorëzohet te Rezervat Materiale të Shtetit;

dh) procesverbalin e dorëzimit të mjetit në Rezervat Materiale të Shtetit ose dhe në pikën e ruajtjes;

e) dokumentet identifikuese të mjetit (në rast se ka);

ë) ekstraktet e origjinës ose kopje të dokumenteve identifikuese të drejtuesit të mjetit ose solidarit (në rast se ka);

f) pamje fotografike elektronike (në CD).

4. Plotësimi i dokumentacionit realizohet nga Drejtoria Vendore e Policisë, brenda 10 ditëve nga konfiskimi i mjetit. Mosplotësimi i dokumentacionit brenda këtij afati ose dorëzimi/marrja me mangësi i dokumentacionit të dosjes së mjetit përbën shkelje disiplinore dhe ndaj personave përgjegjës të fillojë ecuria disiplinore në bazë të legjislacionit në fuqi.

5. Rast pas rasti, drejtoritë rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit, së bashku me drejtoritë vendore të Policisë në marrëveshje mes tyre, dorëzimin mund ta bëjnë edhe direkt “de jure” në pikat ekzistuese të ruajtjes së mjeteve në përputhje me dokumentacionin respektiv të dosjes së secilit mjet të konfiskuar dhe mjetet do të vijojnë të ruhen pranë pikave ekzistuese të ruajtjes deri në përfundimin e procedurave të tjetërsimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.

6. Dorëzimi i mjeteve të ndaluara, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga pika 1, e nenit 203 të Kodit Rrugor, të cilat ndodhen në pikat e ruajtjes së strukturave të Policisë së Shtetit, kur plotësojnë afatin 3-mujor të qëndrimit në këto pika, kalojnë në ambientet e Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit, sipas juridiksionit përkatës, me shkresë përcjellëse të komisarariatit rajonal të Policisë Rrugore Tiranë ose sektorit të Policisë Rrugore të qarkut që ka bërë ndalimin administrativ, pa qenë i nevojshëm vendim nga organi administrativ shtetëror.

7. Mjetet e kaluara në Rezervat Materiale të shtetit, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga pika 1 e nenit 203 të Kodit Rrugor, të cilat ndodhen në pikat e ruajtjes së strukturave të Policisë së Shtetit kur plotësojnë afatin 3-mujor të qëndrimit në këto pika, kalojnë në ambientet e

Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit sipas juridiksionit përkatës, me shkresë përcjellëse të Komisarariatit Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë ose sektorit të Policisë Rrugore të qarkut që ka bërë ndalimin administrativ, pa qenë i nevojshëm vendimi nga organi administrativ shtetëror.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në rast se pas shitjes së mjetit:

a) evidenton diferencë të mundshme në lekë, ia kthen atë shkelësit;

b) evidenton se vlera e shitjes rezulton më e ulët se vlera e gjobës, atëherë vlera e shitjes konsiderohet e ardhur përfundimtare në buxhetin e shtetit dhe kryen sistemimin e veprimeve dokumentare dhe të rakordimit të kontabilitetit.

9. Udhëzimi nr. 75, datë 13.3.2014, i ministrit të Brendshëm, “Për procedurat që ndiqen për administrimin e automjeteve dhe motomjeteve që kalojnë në rezervat materiale të shtetit si pasojë e konfiskimit”, shfuqizohet.

10. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit dhe drejtoritë rajonale në varësi të saj, për zbatimin e këtij udhëzimi.

11. Ndjekin zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj

MINISTRI I MBROJTJES
Olta Xhaçka

UDHËZIM
Nr. 2, datë 6.2.2019

PËR ZHVILLIMIN E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR 2019

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 50, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të



nxënësve të arsimit fillor në datën 24 maj 2019, për të gjithë nxënësit e klasave të pesta.

2. Testi është i integruar dhe përfshin lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre.

3. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, fillon në orën 10:00 dhe zgjat 1 orë e 30 minuta.

4. Procedurat e hartimit dhe të vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren “Për procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor 2019”.

5. Nxënësit me aftësi të kufizuara e zhvillojnë vlerësimin e arritjeve në përshtatje me programin mësimor me të cilin punojnë, veçoritë dhe standardin e tyre.

6. Instituti i nxënësve që nuk shikojnë tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), një ditë para zhvillimit të vlerësimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit Brail.

7. Institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar (IPSCAP) monitoron procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur gjatë zhvillimit të tij.

8. Arkivimi i testeve bëhet pranë institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

9. Sektori i statistikës i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, merr nga Qendra e Vlerësimit të Testit (QVT) dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku është realizuar vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor. Këto të dhëna dërgohen në QSHA dhe MASR.

10. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, RINISË
DHE SPORTIT
Besa Shahini

URDHËR

Nr. 28, datë 30.1.2019

PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE TË STANDARDIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT NR. 2 “PARAQITJA E PASQYRAVE FINANCIARE” DHE STANDARDIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT NR. 9 ‘KOMBINIMET E BIZNESEVE DHE KONSOLIDIMI’, TË PËRMIRËSUAR

Në mbështetje të nenit 4, pikës 3, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar, të vendimit nr. 2, datë 26.9.2018 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit “Për miratimin e ndryshimeve të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 2 dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 9, të përmirësuar”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 2 “Paraqitja e pasqyrave financiare (SKK2)” dhe të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 9 “Kombinimet e bizneseve dhe konsolidimi” (SKK9).

2. Ndryshimet e SKK 2 dhe SKK 9, të përmirësuar, të publikuara në vitin 2018, do të zbatohen në pasqyrat financiare që mbulojnë periudhat kontabël që fillojnë më ose pas datës 1.1.2019. Ndryshimet zbatohen në prospektivë.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCIVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj



NDRYSHIME TË SKK 2 “PARAQITJA E PASQYRAVE FINANCIARE”, I PËRMIRËSUAR

Paragrafët 31A, 31B, 31 C dhe 52A janë shtuar të rinj. Paragrafët 25, 26, 29, 31, 46, 52, 60 dhe 95 janë ndryshuar. Teksti i shtuar është i nënvizuar, teksti i fshirë ka vizë në mes.

OBJEKTIVAT DHE BAZAT E PËRGATITJES

25. Në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, pasqyrat financiare ~~përgatiten dhe paraqiten~~ në lekë, duke treguar shkallën e rrumbullakimit të shifrave (për shembull, në mijë lekë).

26. Një njësi ekonomike do të identifikojë qartë secilën prej pasqyrave financiare dhe shënimet e tyre shpjeguese, duke i dalluar ato nga çdo informacion tjetër jashtë këtij seti pasqyrash. Përveç kësaj, njësi ekonomike duhet të paraqesë informacionin e mëposhtëm dhe ta përsërisë atë kur është e nevojshme për të kuptuar informacionin e paraqitur:

a) informacioni i nevojshëm për të identifikuar njësinë ekonomike:

i. emri i njësisë ekonomike dhe çdo ndryshim në emrin e saj që nga fundi i periudhës së mëparshme;

ii. regjistri ku mbahen të dhënat për njësinë ekonomike;

iii. numri që ka njësi ekonomike në regjistrin tregtar.

b) nëse pasqyrat financiare mbulojnë njësi ekonomike individuale ose një grup të njësive ekonomike;

c) datën e përfundimit të periudhës raportuese dhe periudhën e mbuluar nga pasqyrat financiare;

d) monedhën e paraqitjes (lekë), siç përcaktohet në paragrafin 25 të këtij Standardi.

e) nivelin e rrumbullakosjes, nëse ka, i përdorur në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Rregulla të përgjithshme

29. a) Pasqyra e pozicionit financiar paraqet informacionin mbi pozicionin financiar të njësive ekonomike në fund të periudhës raportuese.

b) Në pasqyrën e pozicionit financiar tepricat

e çeljes për çdo periudhë raportuese duhet të korespondojnë me tepricat e mbylljes së periudhës raportuese paraardhëse.

c) Pasqyra e pozicionit financiar ka tre përbërës kryesorë:

a) aktivet që kontrollojnë njësia ekonomike;

bi) detyrimet që duhet të përmbushë njësia ekonomike;

ëiii) kapitalin e pronarëve të njësive ekonomike.

31. Kategoritë e zërave të aktiveve dhe detyrimeve në pasqyrën e pozicionit financiar *(paraqitur me ngjyrë të zezë të theksuar në shtojcën 1)* duhet të respektohen, megjithëse mund të shtohen zëra të tjerë, nëse ata ndikojnë në përmirësimin e qartësisë dhe lexueshmërisë së pasqyrës së pozicionit financiar. Nënkatëgoritë e pasqyrës së pozicionit financiar mund të paraqiten në shënimet shpjeguese në vend që të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar. Duke u bazuar në konceptin e materialitetit, zërat jomaterialë mund të paraqiten të grupuar.

31A. Kur një aktiv ose detyrim lidhet me më shumë se një zë të caktuar në pasqyrën e pozicionit financiar, marrëdhënia e tij me zërat e tjerë do të shpjegohet në shënimet që shoqërojnë pasqyrat financiare.

31B. Të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme dhe të drejta të tjera të ngjashme do të paraqiten nën zërin “Toka dhe ndërtesa”.

31C. Kur shumat për shlyerjen e një huaje është më e madhe se vlera e huas, njësive ekonomike i kërkohet ta paraqesë diferencën si një aktiv. Diferenca mund të tregohet në pasqyrën e pozicionit financiar ose të shënimet shpjeguese. Diferenca pakësohet çdo vit me një shumë të arsyeshme dhe shuarja e plotë bëhet jo më vonë se shlyerja e huas.

Kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve (njohja në shumën neto)

46. Në përputhje me parimin e kompensimit



të përshkruar në paragrafët 64 dhe 65 të SKK 1 *Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare*, aktivet dhe detyrimet do të kompensohen në pasqyrën e pozicionit financiar, vetëm nëse njësia ekonomike ka të drejtë ligjore t'i kompensojë aktivet dhe detyrimet, si dhe kur ekziston mundësia që njësia ta përdorë këtë të drejtë. Shumat e kompensuara duhet të jepen për vlerën bruto të tyre të shënimit shpjeguese.

PASQYRA E PERFORMANCËS

Rregulla të Përgjithshme

Kërkesat e zbatueshme

52. Një njësi ekonomike nuk duhet t'i paraqesë ~~apo t'i përshkruajë~~ zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve si zëra të jashtëzakonshëm në pasqyrën e performancës ~~ose në shënimet shpjeguese.~~ Një njësi ekonomike jep informacion në shënimet shpjeguese për shumën dhe natyrën e atyre zërave individuale të të ardhurave apo shpenzimeve të cilët janë të jashtëzakonshëm për nga madhësia apo mundësia e ndodhjes.

52A. Njësitë ekonomike me interes publik, që zbatojnë këtë standard për paraqitjen e pasqyrave financiare, për shumën e të ardhurave të shfrytëzimit paraqitur në pasqyrën e performancës, japin informacion në shënimet shpjeguese lidhur me ndarjen e saj sipas kategorive të aktivitetit dhe tregjeve gjeografike, për sa kohë këto kategori dhe tregje ndryshojnë ndjeshëm nga njëri tjetri, referuar mënyrës si janë organizuar shitjet e produkteve dhe ofrimi i shërbimeve. Lejohet përjashtimi vetëm në rastet kur një rregullim ligjor apo administrativ e justifikon të dëmshëm për njësinë ekonomike dhënien e këtij informacioni. Në shënimet shpjeguese jepen arsyet përse ky informacion mungon.

Kompensimi i të ardhurave dhe shpenzimeve (njohja në shumën neto)

60. Në përgjithësi, të ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen të ndara në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pa i kompensuar me njëra-tjetrën. Të ardhurat dhe shpenzimet, që lidhen

me aktivitetet dytësore, mund të kompensohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, nëse kjo jep një pamje më të vërtetë të natyrës së transaksioneve. Shumat e kompensuara duhet të jepen për vlerën bruto të tyre të shënimit shpjeguese.

Më poshtë jepen shembuj të situatave të kompensimit të të ardhurave me shpenzimet ku rezultati njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në shumën neto:

a) fitimet/humbjet, që vijnë nga shitja e aktiveve afatgjata materiale, raportohen në shumën neto (të ardhurat nga shitja e aktiveve afatgjata materiale minus vlerën kontabël neto të aktivitetit);

b) shpenzimet e qirasë të qiramarrësit kompensohen me të ardhurat nga qiraja që gjenerohen nga dhënia e mëtejshme me qira e të njëjtit aktiv (duke supozuar që qiraja nuk është aktivitet parësor i njësisë ekonomike);

c) fitimet/humbjet që vijnë nga ndryshimet e kursit të këmbimit raportohen neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve;

d) fitimet/humbjet nga zbatimi i metodës së kapitalit raportohen neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve;

e) fitimet/humbjet nga shitja dhe rivlerësimi i investimeve financiare raportohen neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

DATA DHE RREGULLAT E ZBATIMIT TË STANDARDEVE

95. ~~Ky standard~~ SKK 2 i përmirësuar do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël, që fillojnë më ose pas datës 1.1.2015. Ky Standard duhet të zbatohet në mënyrë prospektive.

Ndryshimet e SKK 2 të përmirësuar, të publikuara në vitin 2018, do të zbatohen në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël që fillojnë më ose pas datës 1.1.2019. Ndryshimet zbatohen në mënyrë prospektive.



NDRYSHIME TË SKK 9 “KOMBINIMET E BIZNESEVE DHE KONSOLIDIMI”, I PËRMIRËSUAR

Paragrafët 34 A, 41A1, 41A2, 48A, 60A, 61A1 dhe 61A2 janë shtuar të rinj. Paragrafët 35, 61 dhe 64 janë ndryshuar. Paragrafi 41 është fshirë. Teksti i shtuar është i nënvizuar, teksti i fshirë ka vizë në mes.

KONSOLIDIMI

Njësitë e kontrolluara - Kërkesat për paraqitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara

34A. Kur një njësi ekonomike e përfshirë në konsolidim ka një interes pjesëmarrës në një njësi tjetër ekonomike, informacioni financiar për këtë të fundit paraqitet në pasqyrat financiare të konsoliduara si zë më vete me një përshkrim të përshtatshëm.

35 Një shoqëri mëmë nuk ~~duhet të paraqesë paraqet~~ pasqyra financiare të konsoliduara nëse:

a) plotësohen të dyja kushtet vijuese:

i. shoqëria mëmë është vetë një njësi e kontrolluar nga një njësi ekonomike tjetër mëmë që:

- zotëron 100% të aksioneve të njësisë ekonomike të përjashtuar nga detyrimi për hartimin e pasqyrave të konsoliduara ose;

- zotëron 90% apo më shumë të aksioneve të njësisë ekonomike të përjashtuar dhe pjesa tjetër e aksionarëve e kanë aprovuar përjashtimin nga detyrimi i hartimit të pasqyrave të konsoliduara; dhe

ii. ~~shoqëria~~ njësia ekonomike mëmë e njësisë ekonomike të përjashtuar nga detyrimi për konsolidimin e pasqyrave financiare përfundimtare e saj (ose ndonjë shoqëri mëmë e ndërmjetme) përgatit pasqyra financiare të konsoliduara të qëllimit të përgjithshëm që pajtohen me të gjitha SKK-të ose me këtë SKK; ose

b) ajo nuk ka njësi të kontrolluar përveç atyre të blera me qëllimin e shitjes ose mbylljes brenda një viti. Një shoqëri mëmë duhet ta kontabilizojë këtë njësi të kontrolluar me kosto minus zhvlerësimin.

~~41. Një njësi e kontrolluar nuk përjashtohet nga konsolidimi sepse ajo ushtron aktivitetin e saj në një juridiksion që imponon kufizime për transferimin e mjeteve monetare ose aktiveve të tjera jashtë juridiksionit.~~

41A1. Në pasqyrat financiare të konsoliduara nuk është nevoja të përfshihet një njësi

ekonomike, edhe nëse është një njësi ekonomike me interes publik, kur përmbushet të paktën njëri prej kushteve të mëposhtme:

a) në raste tejet të rralla kur informacioni i nevojshëm për hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me këtë Standard nuk mund të sigurohet pa shpenzime ose vonesa të pajustificueshme;

b) kufizime të forta dhe afatgjata i imponojnë njësisë ekonomike mëmë mosushtimin e të drejtave të saj mbi aktivet ose menaxhimin e njësisë ekonomike që nuk përfshihet në konsolidim”;

41A2. Çdo njësi ekonomike, përfshirë edhe njësitë ekonomike me interes publik, përjashtohen nga detyrimi për të paraqitur pasqyra financiare të konsoliduara nëse:

a) ka vetëm njësi bija të tilla që individualisht apo të marra së bashku janë jomateriale; ose

b) të gjitha njësitë ekonomike bija përjashtohen nga konsolidimi sipas paragrafit 41A1.

Data të njëjta raportimi

48A. Standardi lejon ose kërkon që pasqyrat financiare të konsoliduara të përpilohen në një datë tjetër, të ndryshme nga sa përcaktohet në paragrafin 48 të këtij Standardi, në rastet kur drejtimi gjykon se është me rëndësi të merren në konsideratë datat e pasqyrave financiare të numrit më të madh të njësisë ekonomike ose të njësisë ekonomike më të rëndësishme të përfshira në konsolidim, me kusht që:

- ky fakt të bëhet i ditur në shënimet e pasqyrave financiare dhe të jepen arsyet për këtë;

- të mbahen në konsideratë, ose të bëhen të ditura, ngjarjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me aktivet dhe detyrimet, pozicionin financiar dhe fitimin ose humbjen e një njësisë ekonomike të përfshira në konsolidim, ngjarje këto që kanë ndodhur që nga data e raportimit të asaj njësie ekonomike deri në datën e pasqyrave financiare të konsoliduara; dhe

kur data e raportimit të një njësie ekonomike



është përpara ose pas datës së pasqyrave financiare të konsoliduara me një diferencë prej më shumë se tre muajsh, ajo njësi ekonomike konsolidohet në bazë të pasqyrave financiare të ndërmjetme të hartuara në datën e pasqyrave financiare të konsoliduara.

SHËNIMET SHPJEGUESE

Për të gjitha kombinimet e biznesit

60A. Në shënimet e pasqyrave financiare shpjegohen:

- metodat e përdorura për llogaritjen e vlerës së emrit të mirë në kombinimin e biznesit;

- çdo ndryshim i rëndësishëm i vlerës së tij në raport me vitin paraardhës financiar.

Njësitë e kontrolluara

Dhënia e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare të konsoliduara

61. Në shënimet shpjeguese të pasqyrat pasqyrave financiare të konsoliduara duhen bërë deklaratimet e mëposhtme:

a) fakti që pasqyrat janë pasqyra financiare të konsoliduara.

b) baza për arritjen në konkluzionin se kontrolli ekziston kur shoqëria mëmë nuk zotëron, direkt ose indirekt përmes njërive të kontrolluara, më shumë se gjysmën e fuqisë votuese.

c) çdo ndryshim midis datave të raportimit të pasqyrave financiare të shoqërisë mëmë dhe njërive të kontrolluara prej saj të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara.

d) natyrën dhe shtrirjen e çdo kufizimi domethënës (p.sh., që rezultojnë nga marrëveshjet e huamarrjes ose kërkesat rregullatore) mbi aftësinë e njërive të kontrolluara për t'i transferuar fonde shoqërisë mëmë në formën e dividendëve ose për t'i ripaguar huat.

61A1. Krahës informacioneve që kërkon paragrafi 61, shënimet e pasqyrave financiare të konsoliduara japin edhe informacionet e mëposhtme:

a) në lidhje me njësitë ekonomike të përfshira në konsolidim:

i. emrat dhe selitë e regjistruara të këtyre njërive ekonomike,

ii. përqindjen e kapitalit të mbajtur në këto njësi ekonomike, me përjashtim të mëmës, nga njësitë e tjera ekonomike të përfshira në konsolidim ose nga persona që veprojnë në emër

të tyre por për llogari të atyre njërive ekonomike; dhe

iii. informacion se cili prej kushteve të përmendura në këtë Standard ka përbërë bazën mbi të cilën është bërë konsolidimi.

b) emrat dhe selinë e regjistruar të njërive ekonomike ku njësitë e përfshira në konsolidim kanë interesa pjesëmarrëse dhe përqindjen e kapitalit të tyre të mbajtur nga njësitë ekonomike të përfshira në konsolidim ose nga persona që veprojnë në emër të tyre por për llogari të atyre njërive;

c) emrat dhe selinë e regjistruar të njërive ekonomike të konsoliduara në mënyrë proporcionale, faktorët mbi të cilët mbështetet administrimi i përbashkët i atyre njërive ekonomike dhe përqindjen e kapitalit të tyre të mbajtur nga njësitë ekonomike të përfshira në konsolidim ose nga persona që veprojnë në emër të tyre, por për llogari të atyre njërive; dhe

d) në lidhje me secilën prej njërive ekonomike, me përjashtim të atyre në të cilën njësitë ekonomike të përfshira në konsolidim, ose vetë ose përmes personave që veprojnë në emër të tyre por për llogari të njërive ekonomike, mbajnë një interes në pjesëmarrje:

i. emrat dhe selitë e regjistruara të këtyre njërive ekonomike;

ii. përqindjen e mbajtur në kapital;

iii. shumën e kapitalit dhe rezervave dhe fitimit ose humbjes për vitin më të fundit financiar të njësisë ekonomike në fjalë për të cilin janë miratuar pasqyrat financiare.

Informacioni për kapitalin dhe rezervat dhe për fitimin ose humbjen mund të mosparaqitet kur njësia ekonomike në fjalë nuk e publikon pasqyrën e pozicionit financiar.

61A2. Kur një njësi ekonomike mëmë përjashtohet nga detyrimi për të paraqitur pasqyra financiare të konsoliduara sipas paragrafit 35 të këtij Standardi, atëherë:

a) shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të njësisë ekonomike të përjashtuar japin informacionet e mëposhtme:

i. emrin dhe selinë e regjistruar të njësisë ekonomike mëmë që paraqet pasqyrat financiare të konsoliduara të përmendura në pikën “a”, të paragrafit 35; dhe

ii. përjashtimin nga detyrimi për të paraqitur pasqyra financiare të konsoliduara dhe një raport



drejtimi të konsoliduar.

b) njësia ekonomike e përjashtuar nga detyrimi për të paraqitur pasqyra të konsoliduara publikon

- pasqyrat financiare të konsoliduara të përmendura në paragrafin 35 të këtij Standardi, pika “a”, si dhe raportin e konsoliduar të ecurisë vjetore të përgatitur nga njësia ekonomike mëmë; dhe

- raportin e auditimit të njësisë ekonomike mëmë;

DATA E HYRJES NË ZBATIM

64. Ky standard SKK i përmirësuar do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël, që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015. Ky standard duhet të zbatohet në mënyrë prospektive.

Ndryshimet e SKK 9 të përmirësuar, të publikuara në vitin 2018, do të zbatohen në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël që fillojnë më ose pas datës 1.1.2019. Ndryshimet zbatohen në mënyrë prospektive.

URDHËR

Nr. 21, datë 31.1.2019

PËR DELEGIMIN DHE DISA RREGULLA TË PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 28, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në proceset gjyqësore kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit/personave që do të përfaqësojnë ministrinë.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, kur thirret si palë në gjykim, në proceset gjyqësore, në të cilat, objekti i padisë ka lidhje me institucionin e varësisë, lëshohen në emër të personit/personave që do të përfaqësojnë ministrinë, nga drejtuesi i institucionit të varësisë, sipas vendit ku është ngritur kërkesëpadia.

3. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në

proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor bëhet nga juristë, si dhe përfaqësues nga institucionet e varësisë së Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet autorizimit përkatës.

5. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në proceset gjyqësore, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesve të autorizuar të kryejnë çdo veprim procedural, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit.

6. Përfaqësuesit e caktuar të ndjekin me korrektësi seancat gjyqësore, për sa i takon pjesëmarrjes së tyre, e veçanërisht kontributit provues, paraqitjes së kërkesave, propësimeve, pretendimeve, ankimeve, rekurseve, si dhe dokumenteve të tjera, që do të ndihmonin mbrojtjen e interesave të institucionit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

7. Ngarkohen të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të caktojnë një person përgjegjës që do të jetë pikë kontakti për të shkëmbyer çdo informacion të nevojshëm, si dhe njoftim për ecurinë e ndjekjen e proceseve gjyqësore, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

8. Ngarkohet Sektori i Burimeve Njerëzore dhe i Arkiv-Protokollit për vënien në dispozicion të dokumenteve të nevojshme me qëllim paraqitjen e tyre konform ligjit, në cilësinë e provave materiale për proceset gjyqësore.

9. Ky urdhër nuk cenon vlefshmërinë e autorizimeve të lëshuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për proceset gjyqësore në të cilat ky institucion ka qenë palë dhe që kanë filluar përpara hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

10. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, Sektori i Këshillimit Ligjor dhe Monitorimit të Impaktit të Akteve Rregullatore, institucionet e varësisë së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TURIZMIT



DHE MJEDISIT
(SEKRETARI I PËRGJITHSHËM/INSTITUCIONI I VARËSISË)

Blendi Klosi

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.2019

AUTORIZIM PËR PËRFAQËSIMIN NË ÇËSHTJEN GJYQËSORE ME PALË:

Paditës:

E paditur:

Objekti:

Në mbështetje të neneve 64–77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, nenit 14, të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, dhe të urdhrit të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr., datë, “Për delegim dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”,

VENDOSA:

Autorizimin e ...dhe....., për të përfaqësuar Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, së bashku ose veç e veç, në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit, në të gjitha seancat gjyqësore të procesit me nr. ... akti, pranë Gjykatës.....

Përfaqësuesi ka të drejtë të përgatisë, të nënshkruajë e të depozitojë të gjitha aktet nevojshme procedurale para Gjykatës në përputhje me ligjin dhe në interesin e ligjshëm të palës së paditur, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të cilën përfaqëson, deri në marrjen e formës së prerë të vendimit.

(SEKRETARI I PËRGJITHSHËM/DREJTUESI I INSTITUCIONIT TË VARËSISË)

URDHËR

Nr. 32, datë 5.2.2019

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Zëvendësministrit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, z. Erjon Luçi.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, deleguar sipas pikës 1 (një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data 5.2.2019 deri më 8.2.2019.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Financave dhe

Ekonomisë, z. Erjon Luçi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCVE

DHE EKONOMISË

Anila Denaj

URDHËR

Nr. 85, datë 8.2.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për Arkivat”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z. Endrit Musaj, drejtor i Inspektimit dhe Trajnimeve, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.

2. Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të



Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 11.2.2019 deri në datën 17.2.2019.

3. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore, të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve dhe do t'ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

5. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve, z. Endrit Musaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

VENDIM
Nr. 30, datë 14.2.2019

**MBI MIRATIMIN E VENDIMIT PËR
RREGULLAT DHE PROCEDURËN E
CAKTIMIT TË GJYQTARIT PËR
GJYKIMIN E NJË ÇËSHTJEJE
GJYQËSORE TË VEÇANTË NË NJË
GJYKATË TJETËR, TË NDRYSHME
NGA AJO KU USHTRON FUNKSIONIN
NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i mbledhur sot më datë 14.2.2019, bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1, germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 2 dhe 89, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Miratimin e vendimit “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Kërkesat e ardhura para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nga kryetarët e gjykatave, nëpërmjet të cilave është kërkuar delegim i gjyqtarëve për të plotësuar trupat gjykues, do të

trajtohen bazuar në rregullat dhe procedurën e parashikuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Naureda Llagami

VENDIM
PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT
E CAKTIMIT TË GJYQTARIT PËR
GJYKIMIN E NJË ÇËSHTJEJE
GJYQËSORE TË VEÇANTË NË NJË
GJYKATË TJETËR, TË NDRYSHME
NGA AJO KU USHTRON FUNKSIONIN
NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1, germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 2 dhe 89 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, me autoritetin që i buron nga Kushtetuta për të siguruar pavarësinë, përgjegjëshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor,

VENDOSI:

I. Objekti

1. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave të detajuara për kriteret dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.

II. Fusha e zbatimit

1. Ky vendim aplikohet në rast të pamundësisë së zbatimit të neneve 45 dhe 46 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

III. Përkufizime

1. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Caktimi i gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë” nënkupton caktimin e një gjyqtari, nga gjykata ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, në një gjykatë tjetër, kur kjo e fundit ka një nevojë konkrete që lidhet me gjykimin e një ose disa



çështjeve gjyqësore.

b) “Nevojat e gjykatës” nënkupton mungesën apo padisponueshmërinë ligjore të gjyqtarëve të një gjykate për gjykimin e një apo disa çështjeve gjyqësore.

IV. Parimet dhe kriteret e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme

1. Procesi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, kryhet në respektim të parimeve të pavarësisë, të paanësisë, të palëvizshmërisë dhe të transparencës, si dhe të detyrimit kushtetues për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor.

2. Caktimi i gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, bëhet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbi bazën e shortit të hedhur ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të të njëjtë nivel gjykimi.

3. Në caktimin e gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, Këshilli i Lartë Gjyqësor mban parasysh mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor në përgjithësi, situatën në gjykatat mes të cilave ndodh caktimi i gjyqtarit në veçanti, si dhe ngarkesën individuale të punës së gjyqtarit që caktohet.

4. Gjyqtari, brenda të njëjtës periudhe kohe, si rregull, nuk caktohet të gjykojë çështje gjyqësore të veçanta në më shumë se një gjykatë, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme. Përgjatimisht, referuar nevojave dhe urgjencës, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të vendosë ndryshe.

5. Këshilli i Lartë i Gjyqësor në caktimin e gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, mban parasysh tërësinë e kriterëve si më poshtë:

a) afërsinë gjeografike të gjykatës në nevojë me atë nga e cila caktohet gjyqtari;

b) juridiksionin në nivel apeli të gjykatës në

nevojë dhe asaj nga e cila caktohet gjyqtari;

c) lëndën e çështjes gjyqësore për gjykimin e të cilës gjykata është në nevojë;

ç) ndarjen në seksione të gjykatës nga e cila caktohet gjyqtari;

d) ngarkesën e gjyqtarëve të gjykatës nga e cila caktohet gjyqtari;

e) shpërndarjen e barabartë dhe caktimit me efektivitetin të gjyqtarëve.

V. Paraqitja e kërkesës për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme

1. Kryetari, jo më vonë se tre ditë pune nga verifikimi i një nevoje konkrete, i drejtohet Këshillit të Lartë Gjyqësor për caktimin e një gjyqtarit për gjykimin për një ose disa çështje gjyqësore.

2. Kërkesa paraqitet sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi.

VI. Shqyrtimi i kërkesës për caktimin e gjyqtarit për një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme

1. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës shqyrton kërkesën për caktim gjyqtari, për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, në varësi të shkallës së urgjencës së saj.

2. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës kërkon dhe merr nga kryetarët e gjykatave informacionin e nevojshëm sipas paragrafit 5, pika 4, gjerat “ç” dhe “d” të këtij vendimi.

3. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, për lehtësi të trajtimit të kërkesave, të dhënat e nevojshme i përpunon në formë tabelore.

4. Për kërkesën apo grup-kërkesat për caktim gjyqtari që paraqiten nga e njëjta gjykatë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një relacion me shkrim, përmes të cilit, në zbatim të kriterëve të këtij vendimi, i propozon Këshillit të Lartë të Gjyqësor gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e tyre, si dhe numrin përkatës të gjyqtarëve.

5. Këshilli i Lartë i Gjyqësor vlerëson pajtueshmërinë e propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës me kriteret e përcaktuara në këtë vendim, duke miratuar propozimin e



Komisionit ose duke vendosur në një mënyrë tjetër.

VII. Caktimi i gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme

1. Caktimi i gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, si rregull, nëse kjo është e mundur, bëhet nëpërmjet përzgjedhjes me anë të shortit elektronik. Kur kjo nuk është e mundur, përzgjedhja e gjyqtarit bëhet nëpërmjet shortit manual.

2. Nëse nevoja e gjykatës konsiston vetëm në një çështje gjyqësore të veçantë, gjyqtari që caktohet për gjykimin e saj përzgjidhet me short nga gjyqtarët e gjykatës së përcaktuar më parë.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në parimin e efektivitetit, cakton një gjyqtar për gjykimin e më shumë se një çështjeje në të njëjtën gjykatë. Këshilli vlerëson kompleksitetin dhe numrin e çështjeve gjyqësore, ku caktohet gjyqtari.

4. Në rastin e nevojave të gjykatës së apelit për një çështje gjyqësore të veçantë, që konsiston në caktimin e më shumë se një gjyqtari për gjykimin e saj, si rregull, përzgjedhja me short e një gjyqtari nga gjyqtarët e gjykatës së apelit të përcaktuar më parë, nënkupton përzgjedhjen me short, për gjykimin e asaj çështjeje gjyqësore edhe të gjyqtarëve të tjerë që janë në të njëjtin trup gjykues me gjyqtarin e përzgjedhur i pari, i cili do të jetë relatori i çështjes. Kur nevoja konsiston në caktimin e dy gjyqtarëve, përveç gjyqtarit të përzgjedhur i pari me short, gjyqtari tjetër caktohet duke u përzgjedhur, përmes shortit, midis dy gjyqtarëve të tjerë të trupit gjykues ku bën pjesë gjyqtari i përzgjedhur i pari.

5. Për shortin ndiqen procedurat e përcaktuara në pikën IX të këtij vendimi.

VIII. Përfshirja e gjyqtarit nga caktimi për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme

1. Përfshirja nga shorti çdo gjyqtar i identifikuar se ka pengesë ligjore për të gjykuar një çështje gjyqësore të veçantë.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos përfshirjen nga shorti deri në tre muaj të një gjyqtari, i cili është caktuar për të gjykuar në 10

çështje gjyqësore ose në 5 çështje në gjykatat për krime të rënda.

3. Kryetari i gjykatës së rrethit gjyqësor dhe i gjykatës së apelit, për shkak të përgjegjësisë të tjera që vijnë nga ushtrimi i funksionit respektiv, si rregull, përfshirë nga kualifikimi si gjyqtar që plotëson kriteret për t'u caktuar për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë. Përfshirja, për arsye objektive, ai përfshihet në listat e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në masën 50% të volumit të çështjeve.

4. Gjyqtari anëtar i Kolegjit Zgjedhor, gjatë periudhës zgjedhore, për shkak të ngarkesës në mosmarrëveshjet zgjedhore, si rregull, përfshirë nga kualifikimi si gjyqtar që plotëson kriteret për t'u caktuar për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë. Përfshirja, për arsye objektive, ai përfshihet në listat e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në masën 50% të volumit të çështjeve.

5. Gjyqtari anëtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për shkak të përgjegjësisë të tjera që vijnë nga ushtrimi i funksionit respektiv, si rregull, përfshirë nga kualifikimi si gjyqtar që plotëson kriteret për t'u caktuar për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë. Përfshirja, për arsye objektive, përfshihet në listat e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në masën 50% të volumit të çështjeve.

6. Me kërkesë të motivuar të gjyqtarit dhe të shoqëruar me aktet e nevojshme provuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor, për arsye shëndetësore, mund të vendosë përfshirjen gjer në gjashtë muaj të një gjyqtari nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta.

IX. Procedura e shortit manual

1. Përmes procedurave të shortit përzgjidhen në mënyrë rastësore një apo disa gjyqtarë për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë të gjykatës në nevojë.

2. Në çdo procedurë shorti, fillimisht identifikohen gjyqtarët që plotësojnë kriteret e caktimit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, duke u shënuar emrat e tyre në një shirit të barabartë letre, me shkrim *Times New Roman*, 14, bold.



3. Më pas, identifikohet çështja gjyqësore e veçantë përmes një numri natyror të vendosur aty për aty, duke u shënuar në një shirit të barabartë letre, me shkrim *Times New Roman*, 14, bold.

4. Shiritat e letrës verifikohen për saktësinë e tyre nga nëpunësi i administratës. Pas verifikimit, ky i fundit i palos shiritat në mënyrë të njëjtë dhe i vendos në kutitë përkatëse duke i përzier, me qëllim garantimin e përzgjedhjes rastësore.

5. Në rastin kur nevoja e gjykatës konsiston vetëm në një çështje gjyqësore të veçantë, pas përzierjes së shiritave në kutinë përkatëse me emrat e gjyqtarëve, tërhiqet njëri prej shiritave të letrës përmes së cilit identifikohet gjyqtari i përzgjedhur nga shorti për gjykimin e asaj çështjeje gjyqësore dhe nëpunësi i administratës e deklaron me zë të lartë emrin e tij.

6. Në rastin kur nevoja e gjykatës konsiston në një numër të kufizuar çështjesh gjyqësore, për të cilat Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur gjykimin e tyre nga një gjyqtar i vetëm, pas përzierjes së shiritave të letrës në kutinë përkatëse me emrat e gjyqtarëve, tërhiqet njëri prej shiritave përmes së cilit identifikohet gjyqtari i përzgjedhur nga shorti për gjykimin e atyre çështjeve gjyqësore dhe nëpunësi i administratës e deklaron me zë të lartë emrin e tij.

7. Në rastin kur nevoja e gjykatës konsiston në disa çështje gjyqësore, për të cilat Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur gjykimin e tyre nga më shumë se një gjyqtar, shorti zhvillohet sipas hapave të mëposhtëm:

a) Fillimisht, pas përzierjes së shiritave të letrës në kutinë përkatëse me emrat e gjyqtarëve, tërhiqen shirita në atë numër që i korrespondon numrit të gjyqtarëve që Këshilli ka vendosur, shirita përmes së cilëve identifikohen gjyqtarët e përzgjedhur nga shorti për gjykimin e atyre çështjeve gjyqësore dhe nëpunësi i administratës i deklaron me zë të lartë emrat e tyre.

b) Shorti më pas vazhdon duke futur shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve të përzgjedhur në këtë mënyrë në një kuti të veçantë.

c) Më tej shorti vazhdon me përzierjen e shiritave të letrës në kutinë përkatëse me numrat e çështjeve gjyqësore, duke u tërhequr njërin prej shiritave, përmes së cilit identifikohet numri i çështjes gjyqësore (caktuar në fillim të procedurës së shortit), që është përzgjedhur nga

shorti dhe nëpunësi i administratës e deklaron me zë të lartë atë.

d) Shorti vijon me përzierjen e shiritave të letrës në kutinë me emrat e gjyqtarëve duke u tërhequr njëri prej shiritave, i cili deklarohet me zë nga nëpunësi i administratës. Gjyqtari, emri i të cilit është i shënuar në shiritin e tërhequr, konsiderohet si i përzgjedhur nga shorti për çështjen gjyqësore, shiriti i të cilës është tërhequr më parë.

e) Në këtë mënyrë, procedura e shortit vijon për të gjitha çështjet gjyqësore për të cilat zhvillohet shorti.

f) Në rastet kur numri i çështjeve gjyqësore për të cilat duhet të hidhet shorti është më i madh se numri i gjyqtarëve, shorti vazhdon duke rifutur përsëri shiritat me emrat e gjyqtarëve në kutinë përkatëse.

8. Në rastin e nevojave të gjykatës së apelit për caktimin e dy gjyqtarëve për një çështje gjyqësore të veçantë, pas përzgjedhjes së një gjyqtari sipas procedurës së përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, gjyqtari tjetër përzgjidhet përmes shortit të hedhur midis dy gjyqtarëve të tjerë të trupit gjykues ku bën pjesë gjyqtari i përzgjedhur i pari. Në këtë rast emrat e dy gjyqtarëve të tjerë shënohen në shirita letre si më lart, duke u vendosur në një kuti të veçantë, ku pas përzierjes së tyre, nëpunësi i administratës tërheq njërin prej tyre dhe deklaron me zë të lartë emrin e gjyqtarit, i cili konsiderohet si i përzgjedhur nga shorti për atë çështje gjyqësore të veçantë.

X. Njoftimi i vendimit të caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme

1. Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor i komunikohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarit të caktuar.

XI. Shpenzimet

1. Përballimi i shpenzimeve të gjyqtarit në rastin e caktimit për gjykimin e një çështjeje të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, do bëhet bazuar në legjislacionin në fuqi.

XII. Hyrja në fuqi

1. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**VENDIM****Nr. 9, datë 6.2.2019****PËR DHËNIEN E MIRATIMIT
PARAPRAK PËR KRYERJEN E
VEPRIMTARISË FINANCIARE SHITESË
NGA BANKA E PARË E INVESTIMEVE,
ALBANIA SHA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 194, pika 4, të ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit”; nenit 23, pikat 1 dhe 3, të nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 18, pika 8, të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, e ndryshuar; pikës 6, të shtojcës 1, të rregullores “Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 36, datë 26.5.2010, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a. të veprimtarisë financiare shtesë të ndërmjetësimit në sigurime, në cilësinë e agentit në sigurime.

2. Autorizohet guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a., pas paraqitjes të licencës së dhënë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Gent Sejko**

VENDIM**Nr. 17, datë 6.2.2019****PËR DHËNIEN E MIRATIMIT
PARAPRAK PËR ZOTËRIMIN NGA
BALFIN SHPK TË 88.95 PËR QIND TË
KAPITALIT AKSIONAR TË BANKËS
TIRANA SHA**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “e”, të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të shkronjës “gj”, të pikës 1, të nenit 24, si dhe të nenit 25, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar; dhe të pikës 18 të shtojcës nr. 1 të rregullores “Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare”, miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës, e ndryshuar; dhe me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për zotërimin e 88.95 për qind të aksioneve me të drejtë vote, të kapitalit aksionar të Bankës Tirana sh.a. nga Balfin sh.p.k., me kusht paraqitjen në Bankën e Shqipërisë të miratimit të Hellenic Financial Stability Fund (HFSF) për shitjen e aksioneve të Bankës Tirana sh.a.

2. Ngarkohet Banka Tirana sh.a. të paraqesë në Bankën e Shqipërisë njoftimet e palëve të Marrëveshjes së Shitjes së Aksioneve për përmbushjen e detyrimeve kontraktore.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes:

a) të hartojë një program specifik për mbikëqyrjen e Bankës Tirana sh.a. dhe ta paraqesë për miratim në mbledhjen e radhës të Këshillit Mbikëqyrës;

b) të ruajë të pandryshuara normat mbikëqyrëse në zbatim për Bankën Tirana sh.a. për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe të likuiditetit për një periudhë, të paktën, 2-vjeçare.



4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

5. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

6. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë të njoftimit që do të bëjë Banka e Shqipërisë për plotësimin e kushtit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gent Sejko

VENDIM

Nr. 9, datë 24.1.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “KONTRATËS PËR SIGURIMIN E SHËRBIMEVE TË BALANCIMIT(KAPACITETIT REZERVË DHE ENERGJISË BALANCUESE) TË SISTEMIT ELEKTRO-ENERGJETIK PËR PERIUDHËN KOHORE 1.1.2019–31.12.2019” MIDIS OST SHA DHE KESH SHA

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 20 germa “h” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; i ndryshuar; “Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017, si dhe nenit 19 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 24.1.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike në lidhje me “Kontratën për sigurimin e shërbimeve të balancimit(kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektro-energetik për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019 midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.”,

konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 65 prot., datë 4.1.2019, ka dërguar në ERE kërkesën për miratimin e Kontratës me nr. 6651, prot., datë 31.12.2018 për shoqërinë KESH sh.a. dhe nr. 8859 prot., datë 31.12.2018 të shoqërisë OST sh.a. “Për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektro-energetik, për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019”, të nënshkruar nga shoqëritë OST sh.a. dhe KESH sh.a.

- Enti Rregullator i Energjisë në bazë të nenit 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ka autoritetin për të miratuar kushtet e përgjithshme të kontratave për shërbimet e rregulluara, të ofruara nga pjesëmarrësit e tregut, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, si dhe të kontratave bilaterale, për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

- ERE me vendimin nr. 194, datë 30.12.2016, ka vendosur “Miratimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat”.

- Shoqëria OST sh.a. në korrespondencë zyrtare ka bërë me dije se, në zbatim të parashikimeve të pikës 2, të nenit 6 të “Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017, OST sh.a. (në cilësinë e palës kontraktuese të shërbimit të balancimit nga KESH sh.a., në kuadër të detyrimit për shërbim publik) dhe KESH sh.a. (në cilësinë e palës ofruese të shërbimit të balancimit), pasi vlerësuan ecurinë pozitive të zbatimit të kontratës për shërbimin e balancimit për vitin 2018, shprehën pëlqimin dhe nënshkruan kontratën për ofrimin e shërbimit të balancimit për vitin 2019, kontratë për të cilën kërkohet edhe miratimi nga ERE.

- Kontrata e dërguar nga shoqëria OST sh.a. dhe e nënshkruar nga përfaqësuesit e të dyja palëve, në tërësinë e saj është në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; i ndryshuar; me VKM-në nr. 244, datë 30.3.2015 “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit,



transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; i ndryshuar; “Rregullat e përkohshme të tregut të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 139, datë 25.8.2016; “Rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017; “Kodin e Transmetimit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 186 datë 10.11.2017; vendimet nr. 23, datë 25.3.2009 dhe nr. 34, datë 13.5.2014, me të cilat Enti Rregullator i Energjisë (ERE), ka vendosur rinovimin përkatësisht të licencave për prodhimin dhe tregtimin të energjisë elektrike, për shoqërinë KESH sh.a. ndryshuar me vendimin nr. 97, datë 17.6.2016, “Mbi miratimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike” dhe vendimin nr. 99, datë 17.6.2016, “Mbi miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike.”, vendimin e Bordit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.”, vendimin e Bordit të ERE-s nr. 134, datë 6.9.2017 “Mbi licencimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit “OST” sh.a., në aktivitetin e Operimit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”, si dhe ka dakordësinë e tyre.

- Palët e kësaj kontrate janë subjekte juridike të legjitimuara për nënshkrimin e kontratës “Për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektro-energetik për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019” midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.”, duke patur parasysh që licenca e shoqërisë OST sh.a., në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike është rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 134, datë 6.9.2017 dhe licenca e shoqërisë KESH sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike është rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 99, datë 17.6.2016.

- Në nenin 7 “Detyrimet e OST-së”, në pikën 7.3 shprehimisht thuhet: “OST, bazuar në konfirmimin e bërë nga KESH-i për muajin pasardhës, jo më vonë se ora 12:00 e ditës së premte të çdo jave, do t’i dërgojë KESH-it kërkesën (skedulin) javor me treguesit indikativë të kapacitetit rezervë në ngritje/ulje të kërkuar për

javën pasardhëse”, duke saktësuar ditën në të cilën duhet të paraqitet kërkesa për skedulin javor.

- Palët në këtë kontratë kanë dakordësuar që, çmimi për sigurimin e kapacitetit të Rezervës së Restaurimit të Frekuencës në drejtim ngritje/ulje është 270 lekë/mw/h. Çmimi për sigurimin e kapacitetit të Rezervës Zëvendësuese (RR) është 400 lekë/mw/h. Këto çmime të dakordësuara nga palët nuk janë objekt i përcaktimit të ERE-s.

- Në bazë të “Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017, në nenin 11 “Çmimet e përdorura në këtë mekanizëm” dhe në nenin 12 “Çmimet e disbalancave dhe shërbimeve të balancimit” të kësaj rregulloreje, parashihet vetëm formula se si do të llogaritet çmimi për njësi lekë/mw/h, ndaj çmimet e propozuara nga palët, nuk janë objekt i përcaktimit të ERE-s. Vihet re që çmimet për këto shërbime mbeten të njëjta më ato të përcaktuara në kontratën e vitit 2018.

- Në këtë kontratë gjithashtu janë bashkëngjitur, si pjesë të pandashme të saj edhe 4 anekse, në të cilat në mënyrë të detajuar janë përshkruar këto të dhëna:

- Aneksi 1:

- Palët kanë dakordësuar dhe specifikuar modalitetet se si rezerva mbajtëse e frekuencës (FCR), rezerva restaurimit të frekuencës (FRR) do të sigurohen nga KESH sh.a.

- Aneksi 2:

- Në këtë aneks janë specifikuar në mënyrë të detajuar aftësitë teknike që duhet të kenë njësitë gjeneruese që marrin pjesë në sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit.

- Aneksi 3:

- Në këtë aneks është specifikuar formati i skedulimit vjetor, mujor dhe ai javor që do të përdoret si bazë për llogaritjen e kapacitetit rezervë.

- Aktivizimin e rezervës së restaurimit automatik (FRR).

- Llogaritjen e rezervës së restaurimit të frekuencës automatike (FRR) do të jetë sipas formulës $C = \text{matja-kërkesë} = B - (A - D)$

- Aneksi 4:

- Paraqet formën e kërkesës për aktivizim e rezervës zëvendësuese (RR) në Kaskadën e Drinit, që do të paraqitet nga pala kontraktore OST sh.a., për dipeçerinë e KESH sh.a.



Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e kontratës “Për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektro-energetik për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019” midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.”.

2. Çmimet dhe tarifat e përmendura në këtë kontratë nuk janë objekt i përcaktimit nga ERE.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a. dhe OST sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin e Konkurrencës, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 10, datë 24.1.2019

MBI MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN PËR NDRYSHIMIN E FURNIZUESIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 113, DATË 8.7.2016

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.1.2019, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 113, datë 8.7.2016 ka miratuar “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”.

- Në datë 6.2.2018 shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 2312 prot. (protokolluar në ERE me nr. 171, datë 12.2.2018), kërkon nga ERE amendimin e dispozitave të kësaj rregulloreje që kanë të bëjnë me lejimin e abonentëve debitorë të ndryshojnë furnizuesin.

- Me vendimin nr. 38, datë 23.2.2018, ERE ka miratuar “Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë OSHEE sh.a., për disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 113, datë 8.7.2016, “Mbi miratimin e rregullores për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Lejimin e abonentëve debitorë të ndryshojnë furnizuesin në rast se debia merret përsipër nga furnizuesi i ri.

- Lejimin e abonentëve debitorë të ndryshojnë furnizuesin në rast se midis furnizuesit të mëparshëm dhe abonentit ka një marrëveshje për likuidim të vonuar të debisë.

- Në shkresën me nr. 219 prot., datë 28.2.2018, ERE i ka dërguar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës; Operatorit të Sistemit të Transmetimit; Avokatit të Popullit; Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES); Shoqata Shqiptare e Energjive të Rinovueshme (AREA); Foreign Investors Association of Albania (FIAA); Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorëve; Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorëve; Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë; Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë; Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, vendimin nr. 38, datë 23.2.2018 “Mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 113, datë 8.7.2016, për komente dhe opinione mbi ndryshimet e propozuara.

- Kompania OST sh.a., me shkresën nr. 219/1 prot., datë 15.3.2018, ndër të tjera citon se, në lidhje me propozimin për ndryshimin e “Rregullores për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin nr. 113, datë 8.7.2016 nuk ka ndonjë koment apo opinion.

- Autoriteti i Konkurrencës në shkresën me nr. 219/3 prot., datë 27.3.2018 citon se ndryshimet në “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”, nuk bien në



kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

- Shoqata shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) nëpërmjet një e-mail-i të protokolluar në ERE me nr. 219/4 prot., datë 5.4.2018, konfirmon dakordësinë e saj lidhur me propozimet e OSHEE sh.a., mbi ndryshimet në “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”.

- Në shkresën me nr. 219/2 prot., datë 20.3.2018, ERE ka njoftuar zhvillimin e një seance dëgjimore me të gjitha grupet e interesit si: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës, Operatori i Sistemit të Transmetimit, Avokati i Popullit, Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), Shoqata Shqiptare e Energjive të Rinovueshme (AREA), Foreign Investors Association of Albania (FIAA), Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorëve, Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorëve, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, për të diskutuar lidhur me këto ndryshime.

- Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore në ERE lidhur me diskutimin e shtesave dhe ndryshimeve të propozuara në “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”, shoqëria OSHEE sh.a., kërkoi shtyrjen e procedurës për vendimmarrjen finale, deri në depozitimin pranë ERE-s, të propozimit për disa ndryshime të reja në rregulloren përkatëse. Palët e tjera pjesëmarrëse në seancë, përkatësisht, OST sh.a., Avokati i Populli, Zyra e Ankesave të Konsumatorëve, dakordësuan shtesat dhe ndryshimet e propozuara më parë nga OSHEE sh.a.

- ERE në shkresën e saj me nr. 219/5 prot., datë 28.5.2018 drejtuar shoqërisë OSHEE sh.a., kërkoi nga kjo e fundit të depozitojë sa më shpejt (duke marrë në konsideratë kohën e gjatë në dispozicion nga marrja e vendimit për fillimin e procedurave) brenda datës 31.5.2018 draftin e ndryshuar të “Rregullores për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”.

- Në shkresën me nr. 171/6 prot., datë 3.1.2019 shoqëria OSHEE sh.a., ka shprehur dakordësinë e saj në lidhje me ndryshimet e propozuara prej saj për të cilat ka filluar

procedura me vendimin nr. 38, datë 23.2.2018. Ndryshimet e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me ligjin nr. 7/2018, bëjnë të nevojshme disa ndryshime në “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”, për të reflektuar kështu përcaktimet e nenit 86, pika 6, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ndryshuar me ligjin nr. 7/2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”

- Ndryshimet vijnë si një koncept i ri në këtë rregullore duke vendosur një garanci më shumë në rastin e klientëve me marrëveshje afatgjata për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për energjinë e konsumuar nga furnizuesi aktual, përpara kalimit të furnizuesin e ri. Kjo shërben për të krijuar mundësinë që edhe nëse në një kohë të dytë këta klientë do të shmangen nga detyrimet me Furnizuesin e Mëparshëm, ky i fundit rezervon të drejtën të ndërpresë furnizimin e tyre me energji elektrike edhe pse kanë ndryshuar furnizues.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”, si më poshtë vijon:

Neni 3 – baza ligjore, paragrafi i parë ndryshon dhe bëhet:

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenet 79, 80, 81, 82, 86, 88;

Neni 4 – përkufizimet, pika 1, ndryshon dhe bëhet:

- “Ligji i energjisë” nënkuptohet, ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me të gjithë ndryshimet;

Neni 5 – procedura për paraqitjen e kërkesës/aplikimit, pas pikës 1 shtohet pika 1.2 me përmbajtjen si më poshtë:

1.2 Ka të drejtë të bëjë kërkesë për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike edhe çdo klient debitorë ndaj furnizuesit të mëparshëm, me kushte që:

a) Debia të merret përsipër nga furnizuesi i ri, sipas një marrëveshje të lidhur nga palët;

b) Në rast se midis furnizuesit të mëparshëm dhe abonentit ka një marrëveshje për likuidim të vonuar të debisë.



1.3 Në qoftë se klienti nuk respekton afatet e pagesave ndaj furnizuesit të mëparshëm, këtij të fundit (furnizuesit të mëparshëm) i lind e drejta të kërkojë menjëherë pranë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike për ish-klientin e tij dhe në këtë rast klienti nuk do të furnizohet me energji elektrike nga asnjë furnizues alternativ. Në çdo rast Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të njoftojë furnizuesin aktual dhe atë të mëparshëm për ekzekutimin e ndërprerjes së kërkuar brenda 48 orëve.

1.4 Në rast se nuk zbatohet marrëveshja sipas pikës 1.2, germa “a”, furnizuesit të mëparshëm i lind e drejta të kërkojë menjëherë pranë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike për ish-klientin e tij dhe në këtë rast klienti nuk do të furnizohet me energji elektrike nga asnjë furnizues alternativ.

Në neni 7 – procedura e ndërrimit të furnizuesit në rastet e ndërrimit të furnizuesi i mundësisë së fundit, shtohet pika 9, me përmbajtjen si më poshtë:

- Pika 9:

Klienti fundor që furnizohet nga furnizuesi i mundësisë së fundit dhe që në kuptim të nenit 109, të ligjit për energjinë, del për herë të parë në treg të liberalizuar, është i detyruar të lidhë një kontratë furnizimi me një furnizues të ri, brenda 2 viteve nga fillimi i kontratës së furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit. Në përfundim të kësaj periudhe, operatori i sistemit ndërpret furnizimin me energji elektrike të këtij klienti. Për qëllime të përcaktimit të fillimit të afatit, sipas kësaj dispozite, llogaritja e afateve fillon nga e nesërmja e ditës kur operatori i rrejtë njofton klientin, në përputhje me parashikimet e nenit 109, të ligjit për energjinë, për plotësimin e kushteve teknike të instalimit të sistemit të matjes për daljen në treg të liberalizuar”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OSHEE sh.a., dhe palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi mbas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

RREGULLORE

MBI NDRYSHIMIN E FURNIZUESIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

PJESA I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Këto rregulla do të normojnë kushtet dhe procedurat për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike, të cilët furnizojnë klientin fundor sipas kontratës së furnizimit, si dhe përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e furnizuesit, klientëve dhe të operatorit të sistemit në kuadër të procedurës së ndryshimit të furnizuesit.

Neni 2

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është vendosja e rregullave për palët në kontratë, për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike dhe garantimin i së drejtës së klientit për të kërkuar ndryshimin e furnizuesit.

Neni 3

Baza ligjore

Kjo rregullore mbështet në:

- Ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenet 79, 80, 81, 82, 88;
- Ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- “Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.5.2016;
- Ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Kodin e Matjes;
- Kodin e Shpërndarjes;
- Kodin e Transmetimit.

Neni 4

Përkufizimet

Përkufizimet pjesë e kësaj rregulloreje kanë kuptimin si më poshtë:

1. “Ligji i energjisë”, nënkuptohet, ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me



të gjithë ndryshimet;

2. “Enti Rregullator i Energjisë” ose “ERE” është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin për “Sektorin e energjisë elektrike”.

3. “I licencuar”, është një person i pajisur me licencë për të zhvilluar aktivitete në sektorin e energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e ligjit për energjinë.

4. “Pika e shpërndarjes”, është pika e përcaktuar si pika e shpërndarjes/furnizimit nga rregullorja, e cila normon kushtet e përgjithshme të furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

5. “Furnizues i ri”, është furnizuesi me të cilin klienti dëshiron të nënshkruajë një kontratë furnizimi në fillim të procedurës për ndryshimin e furnizuesit.

6. “Operator i Sistemit”, është një person juridik, përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes/transmetimit, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar dhe, kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe eficiencën e energjisë.

7. “Furnizues aktual”, është furnizuesi i cili furnizon klientin në fillim të procedurës të ndryshimit të furnizuesit.

8. “Furnizim”, është shitja, përfshirë rishitjen e energjisë elektrike te klientët.

9. “Furnizues”, është një person e licencuar për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit.

10. “Furnizues i mundësisë së fundit”, është një furnizues i caktuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili ofron për një periudhë të kufizuar kohë shërbimin e furnizimit në kushte të rregulluara ndaj klientëve, të cilët nuk kanë mundur të kontraktojnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin e tyre.

11. “Klient”, është një klient shumicë ose fundor i energjisë elektrike.

12. “Klient fundor”, është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak.

13. “Kodi i Shpërndarjes”, është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë

funksionimin e rrjetit të shpërndarjes, si dhe vendosin kushtet e shërbimit që ofrohen nga operatorët e sistemit të shpërndarjes për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes.

14. “Kodi i Transmetimit”, është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë operimin e sistemit të transmetimit, si dhe përcaktojnë kushtet e shërbimit që ofrohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit, në përputhje me rregullat e ENTSO-s

15. “Kodi i Matjes”, është tërësia e normave minimale të detyrueshme për matjen dhe regjistrimin e energjisë elektrike.

16. “Kontrata e furnizimit”, është një kontratë për furnizimin me energji elektrike, por që nuk përfshin derivativët e energjisë elektrike.

17. “Ditë”, do të thotë ditë kalendarike, dhe në çdo rast që përfundimi i afatit përkon me një ditë pushimi apo feste zyrtare, afati shtyhet në ditën e parë të punës pasardhëse.

Neni 5

Procedura për paraqitjen e kërkesës/aplikimit

1. Ka të drejtë të bëjë kërkesë për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike çdo klient i energjisë elektrike, me kusht që të këtë ezauruar të gjitha detyrimet në raport me furnizuesin e parë.

1.2 Ka të drejtë të bëjë kërkesë për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike edhe çdo klient debitorë ndaj furnizuesit të mëparshëm, me kushte që:

a) Debia të merret përsipër nga furnizuesi i ri, sipas një marrëveshje të lidhur nga palët;

b) Në rast se midis furnizuesit të mëparshëm dhe abonentit ka një marrëveshje për likuidim të vonuar të debisë.

1.3 Në qoftë se klienti nuk respekton afatet e pagesave ndaj furnizuesit të mëparshëm, këtij të fundit (furnizuesit të mëparshëm) i lind e drejta të kërkojë menjëherë pranë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike për ish-klientin e tij dhe në këtë rast klienti nuk do të furnizohet me energji elektrike nga asnjë furnizues alternativ. Në çdo rast, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të njoftojë furnizuesin aktual dhe atë të mëparshëm për ekzekutimin e ndërprerjes së kërkuar brenda 48 orëve.



Neni 6

Paraqitja e dokumentacionit

1.4 Në rast se nuk zbatohet marrëveshja sipas pikës 1.2, germa “a”, furnizuesit të mëparshëm i lind e drejta të kërkojë menjëherë pranë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike për ish-klientin e tij dhe në këtë rast klienti nuk do të furnizohet me energji elektrike nga asnjë furnizues alternativ

2. Procedura për ndryshimin e furnizuesit fillon me paraqitjen e një kërkesë dhe dokumentacioni, në kuadër të kësaj rregulloreje, në mënyrë direkte, pranë selive të furnizuesit aktual ose nëpërmjet postës.

3. Së bashku me kërkesën për ndryshim, personi i përcaktuar për pranimin e dokumentacionit do të konfirmojë/vërtetojë marrjen dhe pranimin e aplikimit të tyre.

4. Paraqitja e dokumentacionit do të konsiderohet e vlefshme në datën e pranimin të tij. Pranimi i kërkesës për ndryshimin e furnizuesit do të konsiderohet i vlefshëm në datën kur ai pranohet, sipas afateve të përcaktuara në këtë rregullore.

5. Me pranimin e kërkesës për ndryshimin e furnizuesit nga furnizuesi aktual, klientit i lind e drejta për të aplikuar pranë cilitdo furnizues/furnizuesve të zgjedhur prej tij.

6. Procedura e ndryshimit të furnizuesit nuk mund të tejkalojë afatin 15-ditor, afat i cili fillon nga data e dorëzimit të aplikimit.

7. Klienti i cili ka nënshkruar një kontratë furnizimi duhet të paraqesë aplikimin, siç parashikohet në paragrafin 1, të këtij neni jo më vonë se 15 ditë, përpara periudhës së vlefshme të përfundimit të kontratës në fuqi.

8. Në veçanti, formati duhet të përfshijë:

- të dhënat e shoqërisë tregtare/personit fizik/juridik, selinë/adresën, NUIS/ID, emrin dhe mbiemrin, si dhe të dhënat e klientit kërkuar;
- numrin identifikues të pikës së shpërndarjes/furnizuesit siç paraqitet në bazën e të dhënave të operatorëve të sistemit;
- fuqinë e aprovuar,
- datën e dorëzimit të aplikimit;
- emrin e shoqërisë tregtare të furnizuesit aktual dhe numrin identifikues të kontratës së nënshkruar mes klientit dhe furnizuesit aktual.

1. Mbas paraqitjes së aplikimit siç parashikohet në nenin 5, klienti duhet të paraqesë në dy kopje (njëra e noterizuar dhe tjetra fotokopje) dokumentacionin e mëposhtëm:

2. Një vërtetim, të lëshuar nga furnizuesi aktual me qëllimin për të iniciuar procedurat e ndryshimit të furnizuesit, e cila nuk duhet të lëshohet më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së dorëzimit të aplikimit. Nëpërmjet këtij dokumenti, furnizuesi aktual konfirmon se përgjegjësitë financiare të përbashkëta të kontratës së furnizimit, efektive në ditën që është lëshuar dokumenti, janë zgjidhur mes furnizuesit dhe klientit

3. Pëlqimin e klientit për të përdorur të dhënat personale dhe të dhëna të tjera të përfituara përgjatë procedurës së ndryshimit të furnizuesit, e vlefshme vetëm në funksion të ndryshimit të furnizuesit.

4. Me marrjen e konfirmimit të aplikimit për ndryshim të furnizuesit, furnizuesi i ri do të përcaktojë gjithashtu kohëzgjatjen e shqyrtimit të aplikimit për lidhjen e kontratës së re.

5. Furnizuesi ka detyrimin ta bëjë publik formatin e aplikimit dhe t'i sigurojë klientit në çdo rast një të tillë pa pagesë.

6. Nëse furnizuesi i ri e cilëson aplikimin të pakuptueshëm ose jo të plotë brenda periudhës kohore 3-ditore nga pranimi i tij, ai do të ftojë klientin për të korrigjuar mangësitë në të, si dhe të vërë në dijeni klientin mbi pasojat që vijnë si rezultat i mos-përmbyshjes së kushteve të kërkesës.

7. Nëse furnizuesi i ri evidenton se aplikimi është i pavlefshëm do të njoftojë klientin dhe operatorin e sistemit mbi mospërmbyshjen e kushteve për ndryshimin e furnizuesit.

8. Brenda tri ditëve nga dita e marrjes së deklaratës/kërkesës, furnizuesi aktual ka të drejtën për të paraqitur një ankesë tek operatori i sistemit, nëse konstaton se klienti nuk e plotëson kushtin për ndryshimin e furnizuesit.

9. Nëse furnizuesi aktual paraqet një ankim tek operatori i sistemit, ky i fundit do të informojë klientin dhe furnizuesin e ri mbi mospërmbyshjen e kushteve për ndryshimin e furnizuesit.



10. Nëse furnizuesi aktual nuk paraqet një ankim, si më sipër parashikuar, operatori i sistemit do të mundësojë të dhënat e matjes për pikën/pikat e shkëmbimit të klientit - për të cilën procedura është iniciuar me paraqitjen e aplikimit – brenda 7 (shtatë) ditëve nga afati i fundit për paraqitjen e ankimit.

11. Për sa i përket klientit, operatori i sistemit do të paraqesë të dhënat e matjes për pikën e shpërndarjes, në ditën e përfundimit të kontratës.

12. Nëse gjatë procedurës së ndryshimit të furnizuesit dhe deri në ditën e ndryshimit të furnizuesit, operatori i sistemit merr disa aplikime nga furnizues të ndryshëm për të njëjtën pikë/pika shpërndarje, për të njëjtin klient, operatori i sistemit do të ftojë klientin brenda 3 ditëve që prej ditës që lajmërimi është paraqitur, në mënyrë që të vendosë se me cilin aplikim do të procedojë, duke lajmëruar, gjithashtu, mbi pasojat që rëndojnë në rast mospërbushje të afatit kohor të përcaktuar.

13. Nëse, përgjatë ecures së aplikimit të përcjellë si më sipër, Operatori i Sistemit, pasi ka kontrolluar të dhënat dhe database-n, dhe nëse evidenton pasaktësi të të dhënave të aplikimit, ai do të informojë furnizuesin brenda 3 ditëve mbi këto pasaktësi. Me marrjen e lajmërimit/njoftimit me shkrim nga operatori i sistemit, furnizuesi i ri do të ftojë klientin për të ndryshuar të dhënat e paraqitura në aplikim brenda 3 (tri) ditëve nga dita që klienti është ftuar për të ndryshuar të dhënat e vendosura në aplikim, duke saktësuar një afat kohor për rishikimin.

14. Nëse klienti rishikon aplikimin brenda afatit të përcaktuar, furnizuesi i ri do t'i përcjellë aplikimin e rishikuar operatorit të sistemit brenda 3 ditëve prej marrjes së tij, ndërsa operatori i sistemit do të veprojë sipas nenit 6.

15. Nëse klienti nuk rishikon të dhënat brenda afatit të përcaktuar edhe pse ai është ftuar për të vepruar në këtë mënyrë, furnizuesi i ri do të njoftojë klientin mbi mospërbushjen e kushteve për ndryshimin e furnizuesit brenda afatit dhe jo më shumë se tri ditë nga paraqitja e aplikimit.

16. Të dhënat e matjes të pikë/pikave të shpërndarjes, të cilat janë dhënë nga operatori i sistemit siç parashikohet në këtë nen, duhet të përfshijnë datën së cilës i referohen, datë e cila konsiderohet të jetë dita e ndërrimit të furnizuesit.

17. Në ditën që furnizuesi është ndryshuar, kontrata e furnizimit e nënshkruar mes klientit dhe furnizuesit të ri do të hyjë në fuqi dhe kontrata mes klientit dhe furnizuesit aktual do të pushojë efektet juridike. Pika e shpërndarjes ekzistuese do t'i transferohet furnizuesit të ri.

Neni 7

Procedura e ndërrimit të furnizuesit në rastet e ndërrimit të furnizuesit i mundësisë së fundit

1. Në rast ndryshimi të furnizuesit i mundësisë së fundit, për shkak të falimentimit apo paaftësisë paguese, pezullimit apo heqjes së licencës të furnizuesit aktual, apo kur klienti nuk ka arritur të gjejë një furnizues në treg dita e ndryshimit të furnizuesit do të konsiderohet dita kur pasojat ligjore që kanë çuar në fillimin e procedurave të falimentit dhe procedurat e likuidimit, dhe rastet e tjera të përcaktuara në këtë nen kanë hyrë në fuqi.

2. Furnizuesi aktual është i detyruar të informojë klientët, operatorët e sistemit dhe furnizuesin e mundësisë së fundit në ditën që pasojat ligjore të falimentit dhe likuidimit, apo rrethanave të tjera kanë hyrë në fuqi, pa asnjë vonesë, në harkun kohor jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë duke filluar nga dita që furnizuesi aktual është i vetëdijshëm për paaftësinë e tij për të kryer aktivitetin e furnizimit.

3. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dorëzimi i lajmërimit të furnizuesit aktual, operatori i sistemit duhet të paraqesë të dhënat e matjes për pikën/pikat e shpërndarjes dhe t'ia përcjellë ato klientit, furnizuesit aktual dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.

4. Në rast se licenca e furnizuesit aktual përfundon, është pezulluar apo hequr, pa asnjë vonesë, në harkun kohor të 15 ditëve, nga data e përfundimit të vlefshmërisë së licencës ose nga data e hyrjes në fuqi të vendimit për heqjen ose pezullimin e licencës, ERE do të informojë të gjithë operatorët e sistemit, dhe furnizuesin e mundësisë së fundit mbi heqjen apo pezullimin e licencës së furnizimit.

5. Operatori i sistemit duhet të paraqesë të dhënat e matjes të pikës/pikave të shpërndarjes/furnizimit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dorëzimi i njoftimit në ERE-s dhe të informojë klientët, apo



furnizuesin të cilit i ka përfunduar afati i licencës, shfuqizuar apo revokuar si dhe furnizuesin e mundësisë së fundit.

6. Klienti i cili gëzon të drejtën për t'u furnizuar sipas mundësisë së fundit, i cili nuk ka gjetur një furnizues pas përfundimit të kontratës së shitjes/furnizimit me furnizuesin e mëparshëm, i lind e drejta për të kërkuar për t'u furnizuar nga furnizuesi i mundësisë së fundit për një periudhë jo më shumë se 60 ditë, afat kohor i cili fillon që nga dita e përfundimit të afatit të kontratës së mëparshme të shfuqizuar.

7. Brenda tri ditëve nga dorëzimi i aplikimit për furnizuesin e mundësisë së fundit, ky i fundit duhet të lidhë kontratën e furnizimit me klientin, e cila do të hyjë në fuqi dhe do të fillojë të zbatohet ditën që ndryshohet furnizuesi dhe do të informojë operatorin e sistemit brenda tri ditëve.

8. Në çdo rast dhe jo më vonë se 3 (tri) ditë nga dorëzimi i njoftimit me shkrim të furnizuesit të mundësisë së fundit, operatori i sistemit është i detyruar të paraqesë të dhënat e matjes për pikën/pikat e shpërndarjes dhe të informojë furnizuesin e mundësisë së fundit si dhe klientin.

9. Klienti fundor që furnizohet nga furnizuesi i mundësisë së fundit dhe që në kuptim të nenit 109, të ligjit për energjinë, del për herë të parë në treg të liberalizuar, është i detyruar të lidhë një kontratë furnizimi me një furnizues të ri, brenda 2 viteve nga fillimi i kontratës së furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit. Në përfundim të kësaj periudhe, operatori i sistemit ndërpret furnizimin me energji elektrike të këtij klienti. Për qëllime të përcaktimit të fillimit të afatit, sipas kësaj dispozite, llogaritja e afateve fillon nga e nesërmja e ditës kur operatori i rrjetit njofton klientin, në përputhje me parashikimet e nenit 109, të ligjit për energjinë, për plotësimin e kushteve teknike të instalimit të sistemit të matjes për daljen në treg të liberalizuar.

Neni 8

Të drejtat dhe detyrimet e furnizuesit

1. Një furnizues i energjisë elektrike gëzon të drejtën për të marrë pjesë në procedurën e ndryshimit të furnizuesit në cilësinë e furnizuesit të ri siç parashikohet në këtë rregullore, vetëm nëse furnizuesi është licencuar dhe regjistruar në

regjistrin e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, të mbajtur nga Operatori i Tregut në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

2. Furnizuesi i ri i energjisë, pika e shpërndarjes së të cilit është brenda sistemit të transmetimit, duhet të sigurojë kapacitete në pikën e daljes nga sistemi transmetimit me qëllimin e shpërndarjes së energjisë elektrike ndaj klientit të ri.

PJESA II

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 9

Ankimimi

1. Çdo ankesë lidhur me procedurën e ndryshimit të furnizuesit, mund paraqitet në ERE, brenda 30 ditëve kalendarike.

2. Ankesa nuk pezullon afatin për ndryshimin e furnizuesit dhe/ose të hyrjes në fuqi të kontratës së re të furnizimit.

Neni 10

Rishikimi dhe ndryshimi i rregullave

Kjo rregullore është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi mbas miratimit nga Bordi i ERE-s.

VENDIM

Nr. 13, datë 31.1.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË RTS SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME FUQI TË INSTALUAR 2 mw, NË FSHATIN TREN, BILISHT TË RRETHIT KORÇË

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 germa “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”; nenit 5, pika 1 germa “a” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin



ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; dhe nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 31.1.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë RTS sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik në zonën Tren-Bilisht të rrethit Korçë me fuqi të instaluar 2 mw,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 258, datë 17.12.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë RTS sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me fuqi të instaluar 2 mw.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 55/72, datë 17.12.2018, bëri njoftimi në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 747/1 prot., datë 21.12.2018, dërgoi pranë subjektit njoftimin e vendimit për fillimin e procedurës, si dhe mungesën e dokumentacionit të konstatuar në aplikim i cili konsiston si më poshtë:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, (neni 9, pika 2):

- germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Shkallës së Parë Tiranë). Mungojnë vërtetimet e prokurorisë dhe gjykatës për subjektin RTS sh.p.k.

- germa “g”, dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e veprimtarisë së licencuar). Sa i përket kësaj kërkesë subjekti ka paraqitur në ERE Kontratën e Qirasë nr. 1890 rep. dhe nr. 1077/3 kol., datë 11.9.2018, të lidhur me qiradhënësin Bashkia Devoll, për sipërfaqen 63.915 m² (pronë shtetërore), për një afat 20-vjeçar, por në të cilën nuk parashikohet e drejta e përsëritjes. Në lidhje me këtë dokument, iu kërkuar subjektit sqarimi përkatës për periudhën e mbetur 5-vjeçare, që nuk mbulon kontrata e qirasë, duke qenë se nga studimi i fizibilitetit

rezulton se jetëgjatësia e paneleve është parashikuar të jetë 25 vjet.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3):

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore (për shoqëritë e sapokrijuara vërtetim që nuk ka detyrime): Mungon vërtetimi për kontributet e sigurimeve shoqërore.

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Mungon dokumentacioni mbështetës për financimin nga ortakët.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria RTS sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria RTS sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 19/1, datë 18.1.2019, ka përcjellë në ERE plotësim dokumentacionit.

- Aplikimi i shoqërisë RTS sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”, 4.4.4, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”, si dhe pika 4.4.5, germat “a dhe “b”) është plotësuar në mënyrë korrekte.



- Subjekti RTS sh.p.k. ka lidhur kontratën me nr. 2156 rep. dhe nr. 115/6 kol., datë 8.10.2018, me MIE për një afat 49-vjeçar (dyzetenëntëvjeçar), por nga ana tjetër sqarojmë se, ERE në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet. Por duke qenë se nga të dhënat për projektin e impiantit rezulton se jetëgjatësia e pritshme e një paneli është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për një licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë RTS sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaike, me fuqi të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Tren, Bilisht të Rrethit Korçë, për një afat 25-vjeçar (njëzetepesëvjeçar).

2. Subjekti RTS sh.p.k. në përfundim të afatit 20-vjeçar të kontratës së qirasë, të lidhur me Bashkinë Devoll, të paraqesë në ERE kontratën e rinovuar.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 14, datë 31. 1.2019

MBI SHQYRTIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2018 DHE PLANIT 10-VJEÇAR 2018–2027 TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË SHOQËRISË ALBGAS SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 16, pika 12; nenit 46 dhe nenit 56, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”; nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”; nenit 8 dhe nenit 9, të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 18, datë 10.1.2018, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31. 1.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike në lidhje me shqyrtimin e planit të zhvillimit të investimeve për vitin 2018 dhe planit 10-vjeçar 2018–2027 të zhvillimit të rrjetit të shoqërisë ALBGAS sh.a.

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 120, datë 4.6.2018, filloi procedurën për miratimin e planit të investimeve për vitin 2018 të shoqërisë ALBGAS sh.a. dhe me vendimin nr. 121, datë 4.6.2018, filloi procedurën për miratimin e planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shoqërisë ALBGAS sh.a.

- ERE, me shkresën nr. 454 prot., datë 14.6.2018, bëri me dije shoqërinë ALBGAS sh.a., për vendimmarrjet e sipërcituara, në të cilat pasqyrohej detyrimi për të plotësuar dokumentacionin e munguar sipas kushteve të vendosura në dispozitivët e vendimeve brenda afateve të përcaktuara.

- Në përgjigje të korrespondencës sipërcituar të ERE-s shoqëria ALBGAS sh.a. me shkresën me nr. 454/1 prot. hyrës, datë 13.7.2018, ka informuar ERE-n mbi përmbushjen e detyrimeve mbi Planin e Investimeve për vitin 2018, si dhe Planin 10-vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit. ALBGAS sh.a. për vitin 2018 parashikon projekte të reja në lidhje me ngritjen e kapaciteteve, si dhe trajnimin e stafit në kuadër të investimeve strategjike (Gas Masterplan),



ku gazsjellësi TAP AG do të ketë rol suportues në implementimin e projektit.

- Shoqëria ALBGAS sh.a., në korrespondencën e saj nr. 454/1 prot. hyrës, datë 13.7.2018, ka përcjellë gjithashtu në ERE kërkesën për shtyrjen e afatit të vendosur në pikën 2 të vendimeve nr. 120 dhe nr. 121, datë 4.6.2017, për plotësimin e dokumentacionit të munguar, deri në datën 20.10.2018, për arsyet e sipërcituara dhe me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 454/4 prot., datë 16.10.2018, ka kërkuar nga ERE shtyrjen e afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar deri në datën 20.1.2019.

- Duke marrë në konsideratë kërkesat e shoqërisë ALBGAS sh.a., për shtyrjen e afatit të plotësimit të dokumentacionit të munguar dhe rrethanat në të cilat ishe kjo shoqëri, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 196, datë 30.8.2018, vendosi shtyrjen e afateve për plotësimin e këtij dokumentacioni deri në datën 20.10.2018 dhe me vendimin nr. 235, datë 2.11.2018, vendosi shtyrjen e afateve për plotësimin e këtij dokumentacioni deri në datën 20.1.2019.

- Referuar këtyre vendimeve konstatohet se, afatet e përcaktuara për plotësimin e këtij dokumentacioni nga shoqëria ALBGAS sh.a., janë tejkaluar, gjithashtu kësaj shoqërie dhe përfaqësuesve të saj i është rikujtuar disa herë detyrimi për plotësimin në kohë, të dokumentacionit të munguar.

- ALBGAS sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 10 prot., datë 24.1.2019, bën me dije se do të kryejë disa ndryshime në Planin 10-vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit si rrjedhojë e zhvillimeve të fundit, të cilat janë:

1. Marrëveshja e Ndërmarrjes së përbashkët (Joint Venture) ALBGAS sh.a. dhe “SNAM SPA”.

2. Finalizimi i marrëveshjes së Mirëmbajtjes ndërmjet gazsjellësit TAP AG dhe shoqërisë së përbashkët ALBGAS sh.a. dhe “SNAM SPA”.

3. Shtyrja e investimit për rikonstruksionin e zyrave në Fier të shoqërisë ALBGAS sh.a., për vitin 2019. Investimi për rikonstruksionin e zyrave në Fier nuk u krye gjatë 2018 siç ishte parashikuar sepse kusht për këtë projekt ishte dhe finalizimi i marrëveshjeve të cituara në pikat 1 dhe 2.

- Shoqëria ALBGAS sh.a., kërkon shtyrjen e afatit për dërgimin e Planit Dhjetëvjeçar të

Zhvillimit të Rrjetit të rishikuar, deri më datë 31.10.2019, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

- Plan i investimeve për vitin 2018 të shoqërisë ALBGAS sh.a., ka mungesa të theksuara dokumentacioni dhe argumentesh edhe pas këtyre shtyrjeve siç konsiderohet thelbësore miratimet e këtyre planeve nga Këshilli Mbikëqyrës, si dhe duke qenë se viti 2018 është mbyllur jemi në kushtet se janë ezauruar afatet kohore për mundësinë e miratimit të planit të 2018.

- Sa i takon Planin 10-vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit, duke marrë në konsideratë sa parashtruar nga ALBGAS sh.a., në shkresën e fundit dhe në mënyrë që mos ndikohet procesi i certifikimit të ALBGAS sh.a., është vlerësuar që të merret në konsideratë kërkesa për shtyrjen e afatit për dërgimin e Planit Dhjetëvjeçar të Zhvillimit të Rrjetit të rishikuar deri me datë 31.10.2019, me kushtin që të përditësohet për periudhën 2019 – 2028, siç parashikohet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për këtë qëllim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të refuzojë miratimin e planit të investimeve për vitin 2018 të shoqërisë ALBGAS sh.a.

2. Pika 2 e vendimit nr. 235, datë 2.11.2018, ndryshon dhe bëhet:

- ALBGAS sh.a., të depozitojë pranë ERE-s jo më vonë se data 31.10.2019: miratimin nga Këshilli Mbikëqyrës, të Planit të zhvillimit të rrjetit për periudhën 2019–2028, që reflekton ndryshimet në Planin 10-vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit sipas shkresës nr. 10 prot., datë 24.1.2019,

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë ALBGAS sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

**VENDIM****Nr. 15, datë 31.1.2019****MBI LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR TË TRANS ADRIATIC PIPELINE AG ALBANIA, E REGJISTRUAR PRANË QKB-së, SI DEGË E SHOQËRISË SË HUAJ AKSIONARE (SHA), TRANS ADRIATIC PIPELINE AG**

Në mbështetje të nenit 4, pika 50; nenit 22, pika 2, germa “a” dhe nenit 35, të ligjit nr. 102/2015, datë 23.9.2015 “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe nenit 4, pika 1, germa “a”; nenit 5; nenit 8; nenit 9 pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, germa “a” dhe nenet 10 dhe 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.1.2019, mbasi shqyrtoi relacionin mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline AG Albania, e regjistruar pranë QKB-së si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), Trans Adriatic Pipeline AG, konstatoi se:

- Subjekti Trans Adriatic Pipeline AG, me shkresën nr. 803 prot., datë 24.12.2018 ka paraqitur pranë ERE-s, aplikimin për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 1, datë 9.1.2019, vendosi “Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë Trans Adriatic Pipeline AG në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me komunikimin e datës 10.1.2019, dërgoi pranë subjektit njoftimin e fillimit të procedurës, si dhe mbi mungesën e dokumentacionit të konstatuar në aplikim në fillimin e procedurës. Po ashtu, me shkresën nr. 32, datë 11.1.2019, bëri njoftimi në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 34, datë 14.1.2019, dërgoi pranë subjektit dhe palëve të interesit njoftimin e vendimit.

- Ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit përgjegjës për çështjet e rregullimit të sektorit të

gazit natyror përfshirë të drejtën për të trajtuar çështjet që lidhen me licencimin e subjekteve në aktivitetet e rregulluara të gazit natyror.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 36, datë 31.3.2016, ka miratuar certifikimin përfundimtar të TAP AG si operator i pavarur i transmetimit të gazit natyror.

- “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, në nenin 9, pika 2, germa “a” të saj vendos kushtin se: subjekti që aplikon për një licencë në transmetimin e gazit natyror, duhet që më parë të certifikohet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 37, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”. Siç cituar më lart aktualisht TAP AG me vendimin nr. 36, datë 31.3.2016, është certifikuar si operator i pavarur i gazit natyror.

- Trans Adriatic Pipeline AG Albania rezulton e regjistruar pranë QKB-së, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me numër përkatës identifikimi. Referuar të dhënave të regjistruara në Regjistrin Tregtar për të Dhënat e Subjektit për degët ose zyrtarët e përfaqësimit të shoqërive të huaja, rezulton në cilësinë e përfaqësuesit z. Malfor Nuri.

- Aktiviteti i TAP AG Albania sipas ekstraktit të QKB-së, konsiston në:

- Të veprojë në përputhje me objektivat e shoqërisë të cilat janë të lidhura me planifikimin, zhvillimin dhe të zotërojë pronësinë ligjore të një linje tubacioni gaz, si dhe të çdo pajisje të përfshirë në të.

- Dega mund të angazhohet në çdo aktivitet tregtar financiar ose aktivitete të tjera të cilat janë në përputhje me objektivat e Shqipërisë.

- Objekt i veprimtarisë është: operimi si operator i pavarur i transmetimit të gazit natyror në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 102/2015, datë 23.9.2015 “Për sektorin e gazit natyror”,

- Nga vlerësimi që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga TAP Ag, në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, subjekti ka plotësuar kryesisht dokumentacionin për aplikim si më poshtë:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim:



Neni 9, pika 1:

- germa “a” (tipi i aplikimit) plotësuar;
- germa “b” (informacion i përgjithshëm për aplikantin) plotësuar;
- germa “c” (të dhënat mbi aplikantin) plotësuar;
- germa “d” (dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor), plotësuar si më poshtë:

- pika “i” (akti i regjistrimit në QKB) plotësuar;
- pika “ii” (vërtetim nga organet kompetente që ndaj personit juridik apo personave drejtues kryesorë të shoqërisë nuk ka një vendim të formës së prerë për ndonjë vepër penale) plotësuar;

- pika “iii” Në rastin e subjekteve me nënshitetesi të huaj duhet të vërtetohet rezidenca shqiptare e përfaqësuesit të shoqërisë dhe dëshmi penaliteti. Plotësuar;

- pika “iv” (struktura organizative / lista e personelit). Plotësuar

- pika “v” (identiteti i të gjithë personave që kanë interes pronësor tek aplikanti më të madh dhe të barabartë me 5 %). Plotësuar (aneksi 2.6.);

- pika “vi” (dokumentacioni që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar në territorin e Shqipërisë.) Plotësuar pjesërisht. Subjekti informon se ka fituar të drejtat që lidhen me pronësinë për pronën me statusin toke publike, kryesisht bazuar në vendimet e Këshillit të Ministrave dhe në raste të tjera duke i dërguar shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë mbi listën e parcelave shtetërore të ndikuara nga projekti i gazsjellësit TAP. Për raste të tjera subjekti ka realizuar marrëveshje vullnetare të cilat janë regjistruar në regjistrin e tokave në zyrat përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Sa i përket certifikatës së pronësisë subjekti ka bërë me dije se ky dokument do të vihet në dispozicion sapo të mbyllet procesi në zyrat vendore të pasurive të paluajtshme pas përfundimit të punimeve ndërtimore të të gjithë infrastrukturës së gazsjellësit në territorin e Shqipërisë. Një listë gjithëpërfshirëse e parcelave të tokës të përdorura nga TAP me qëllim ndërtimin e gazsjellësit TAP në territorin e Shqipërisë është paraqitur në aplikim si pjesë e aneksi 3.1. Lidhur me plotësimin pjesërisht të kësaj kërkesë të rregullores konsiderojmë të përtashme vendosjen e kushut të paraqitjes së dokumentacionit të pronësisë jo më vonë se 12

muaj nga vendosja në opim të gazsjellësit.

- (Lejet dhe autorizimet mjedisore). Plotësuar. – Lidhur me këtë pikë subjekti ka bërë me dije se në përputhje me vendimin nr. 3, nr. 210 Prot të AFQ nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Lejeve Mjedisore, TAP-i ka marrë “Lejen mjedisore për ndërtimin dhe funksionimin e Gazsjellësit” (VNMS) më 3 maj 2013. (Përcjelle në aneksin 3.2.)

Neni 9, pika 1, germa “e” (dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale). Plotësuar. Për qëllimet e kësaj kërkesë, TAP-i ka përfshirë certifikatat e Regjistrimit Tatimor nga administrata tatimore e Kantonit të Zug-ut, certifikatë për mungesë borxhi nga zyra e mbledhjes së borxhit, certifikatë për vërtetimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore, certifikate e mungesës së detyrimeve tatimore nga administrata tatimore. Certifikatat e lartpërmendura i janë bashkangjitur aplikimit në aneksin 4.1 deri 4.4, si kopje të noterizuara dhe me vulë apostile.

i. Deklarime të lëshuara prej autoriteteve përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore, në masën që këto detyrime janë plotësuar prej aplikantit. Plotësuar: Me shkresat përkatëse datë 7.12.18 dhe 5.12.18, të njësuara me origjinalin me vulë apostile në të cilat deklarohet se subjekti nuk ka detyrime tatimore dhe gjithashtu ka shlyer të gjitha detyrimet për sigurimet shoqërore. Së fundmi me e-mail-in e datës 29.1.2019, subjekti ka depozituar edhe urdhërpagese për derdhjet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe të detyrimeve tatimore për degën e ngritur në Shqipëri.

ii. Bilancet financiare të audituara nga një shoqëri auditi të akredituar për tri vitet e fundit përpara dorëzimit të aplikimit. Plotësuar.

Paraqitur pasqyrat financiare të nënshkruara të TAP-it, së bashku me raportet e audituesve të akredituar për të tria vitet përpara dorëzimit të aplikimit në ERE, përkatësisht për vitin 2015, 2016 dhe 2017 janë bashkëngjitur në aneksin 4.5 deri 4.7 si kopje të noterizuara dhe me vulë apostile.

Neni 9, pika 1, germa “e”

iii. Garancitë e përshtatshme financiare (neni 4.1.c) dhe tregtare (neni 4.1.ç) dhe garancia e performancës që garantojnë aftësinë e aplikantit lidhur me përmbushjen e detyrimeve të veta në



kuadrin e licencës së kërkuar, përfshire por jo vetëm, largimin përfundimtar të plotë/pjesëshëm të pajisjeve dhe/ose infrastrukturës dhe rehabilitimin e mjedisit si dhe mbështetjen menaxheriale, operacionale dhe financiare nga pronaret e aplikantit. Subjekti ka bërë me dije se nuk zbatohet për TAP-in kjo kërkesë. Lidhur me këtë informacion të TAP-it ky përjashtim vjen në kuadër të marrëveshjes me qeverinë shqiptare (Host Government Agreement) të lidhur në datën 3 prill 2013 ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe TAP AG lidhur me projektin e gazsjellësit të Transadriatic Pipeline, përfshirë vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 233, datë 21.3.2017 “Për miratimin e marrëveshjes së angazhimit për zhvillimin e tregut të gazit dhe marrëveshjes për përfitimet vendase të lidhura ndërmjet republikës së Shqipërisë e cila vepron nëpërmjet KM-së dhe TAP AG lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatic.

iv. Sa i takon kërkesës për një certifikatë sigurimi nga shoqëritë e sigurimit (që veprojnë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi) që vërteton mbulimin e demit nga lëndimet, ose në rastin e humbjes së jetës, ose të humbjes ose shkatërrimit të pronës, të shkaktuar ose që vjen si pasojë e veprimtarisë së aplikantit në kuadrin e licencës së kërkuar në nivel përgjegjësie më të ulët se 10 milionë USD. Kjo policë ose këto polica sigurimi janë dhe mbeten në fuqi dhe veprim të plotë për të gjithë kohëzgjatjen e Licencës së kërkuar. Për më tepër, i licencuari është përgjegjës për të gjitha dëmet që mund të vijnë si pasojë e veprimtarive të kryera gjatë afatit të licencës. Plotësuar. Depozituar certifikata e sigurimit “SIGAL” Polica, datë 11.1.2019.

v. (Vërtetimi i kryerjes së pagesës ndaj ERE, tarifë aplikimi) – plotësuar, evidentohen në aneksin 4.8 dhe rezulton e kryer në datën 20.12.2018.

vi. (Plan Biznesi...) Plotësuar. Subjekti ka depozituar në ERE informacion rreth planit të tij të biznesit referuar operimit.

vii. Nëse aplikanti ka për qëllim të përdorë një shoqëri menaxhimi për veprimtaritë e përditshme, ai informon ERE-n lidhur me këtë qëllim dhe lëshon një garanci performance për kryerjen e veprimtarive në mënyrë të ndershme dhe besueshme nga ana e kësaj shoqërie menaxhimi. Plotësuar. Referuar aplikimit, TAP-i nuk ka

planifikuar angazhimin e një shoqërie menaxhimi për veprimtarinë e vet të përditshme. Kjo dispozitë nuk zbatohet për rastin e TAP-it.

Dokumente specifike për llojin e licencës, është dorëzuar nga aplikanti sa më poshtë:

Neni 9 pika 2, germa “a”:

Licenca për transmetimin e gazit natyror;

a.1 Subjekti që aplikon për një licencë në transmetimin e gazit natyror, duhet që më parë të certifikohet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 37, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”. Plotësuar. Për këtë pikë vlen të theksojmë faktin se siç cituar më lart TAP AG referuar vendimit të ERE-s nr. 36 datë 31.3.2016, është certifikuar si operator i pavarur i gazit natyror.

a.2 Informacion me të dhëna të përgjithshme dhe teknike të projektit që përfshijnë sa vijon:

i. Vendndodhjen e instalimeve dhe gjurmën e tubacioneve përfshirë hartën topografike për territorin ku do të ushtrojnë aktivitetin. Plotësuar. – Subjekti ka depozituar këtë dokumentacion me hartat përkatëse të cilat tregojnë instalimet dhe gjurmët, përfshirë edhe hartat topografike të projektit ku do të ushtrohet aktiviteti. Kjo e dhënë në aneksin 5.3 vendndodhja e instalimit.

ii. Kapacitetin maksimal teknik të kontraktuar dhe të disponueshëm në të gjitha pikat e hyrjes (in take) në sistem dhe të daljes (off take) prej sistemit dhe ndërlidhjet e tij me rrjete të tjera të transmetimit dhe shpërndarjes, impiantet e magazinimit, prodhimit dhe terminalet e GNL. Plotësuar. Subjekti ka deklaruar se ka dhënë detaje për kapacitetet e përmbledhura të rezervuara autoriteteve rregullatore, përfshirë dhe ERE-n, përmes raporteve të ecurisë të dorëzuara dy herë në vit. (Informacion i evidentuar në aneksin 2);

iii. Volumet e projektuara ditore për t'u përpunuar sipas vlerësimeve të aplikantit. Plotësuar.

iv. Standardet teknike, presionet maksimale të projektuara, kërkesat e komprimimit dhe karakteristikat e tjera teknike të makinerive dhe pajisjeve teknike që do të instalohen. Plotësuar. Të dhëna më të hollësishme për këtë pikë janë depozituar në aneksin 5.4 “Lista e kodeve dhe standardet teknike”.

v. Presionet e punës të projektuara mbështetur në vlerësimet e aplikantit. Plotësuar. Të dhënat për këtë pikë janë të përfshira në aneksin 5 (5.1) në Network Code.

vi. Kategoritë dhe lista e konsumatorëve si dhe



livrimet e parashikuara. Plotësuar. Për këtë pikë subjekti ka dhënë të njëjtën përgjigje si për pikën “ii”.

vii. Vendndodhjet e matësve dhe specififikimet. Plotësuar. Për këtë subjekti ka dhënë sqarimet përkatëse referuar përcaktimeve të Kodit të Rrjetit të TAP AG., të evidentuara në mënyrë më të detajuar në aneksin 5.1. të aplikimit.

viii. Vendndodhjet e kontrollit të cilësisë së gazit. Plotësuar. Subjekti ka bërë me dije se sipas seksionit 17 të Projekt Kodit të Rrjetit të TAP-it, mbi sasinë dhe cilësinë matjen e gazit natyror të furnizuar, dhe rifurnizuar nga TAP-i (informacion i dhënë në kaudër të sqarimeve për pikën e mësipërme, aneksi 5.1 i aplikimit)

ix. Dëshmi të kontratave/angazhimeve për transportin e gazit. Plotësuar. Subjekti ka dhënë informacion në kuadër të sqarimeve sipas pikave “ii” dhe “vi” më lart.

x. Kërkesat e pritshme për hyrje prej palëve të treta ose çdo kërkesë e pritshme për përjashtim nga e drejta për hyrje e palëve të treta, sikurse çdo vendim i dhënë më parë për përjashtim prej detyrimit të dhënies së të drejtës së hyrjes për infrastrukturën e reja sipas ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”. Plotësuar. TAP, ndër të tjera, bën me dije se është përjashtuar nga kriteret për aksesin e palëve të treta, rregulloret e tarifave dhe ndarja e pronësisë sipas vendimit të Komisionit Evropian të datës 16 maj 2013 për përjashtimin e gazsjellësit Trans Adriatic nga kërkesat e aksesit të palëve të treta, rregulloret e tarifave dhe ndarjen e pronësisë, të përcaktuara në nenet 9, 32, 41(6), 41(8) dhe 41(10) të direktivës 2009/73/KE. Të tria entet rregullatore të vendeve pritëse të Gazsjellësit TAP, përkatësisht RAE (Greqi), ERE (Shqipëri) dhe AERA (Itali) kanë miratuar Opinionin e Përbashkët të Tre Rregullatorëve të Energjisë për Aplikimin për Përjashtim të TAP AG (Opinionin i Përbashkët Përfundimtar);

xi. Lidhjet ndërkufitare dhe parametrat e operimit në vendet fqinje. Plotësuar. Subjekti ka dhënë informacionin përkatës lidhur me të dhënat për lidhjet ndërkufitare me kufirin greko-shqiptar dhe me atë italian;

xii. Marrëveshjet operationale të balancimit. Plotësuar. Subjekti ka dhënë informacion mbi marrëveshjet e pritshme operationale të balancimit. Përfshirë marrëveshjen me OST shqiptare

ALBGAZ;

xiii. Burimi i synuar dhe procedura e prokurimit të gazit natyror të nevojshëm për balancimin e sistemit të transmetimit. Plotësuar. Subjekti ka bërë me dije se do të hyjë në Marrëveshje operationale, e cili do të jetë pjesë e interkonjeksionit në të ardhmen dhe se procedura e prokurimit të gazit natyror për qëllime të balancimit nuk është përcaktuar ende nga TAP-i. Informacioni rreth balancimit të sistemit të transmetimit ka referencë në aneksin 10 të Projekt Kodit të Rrjetit të TAP-it, i cili gjendet bashkëlidhur aneksit 5.1;

xiv. Aftësia për lëvizjen në kah të kundërt. Plotësuar. Subjekti ka dhënë shpjegime rreth rrjedhjes së kundërt fizike, në aneksin 5.5 të projekt Kodit të Rrjetit të TAP-it;

xv. Punët e aplikantit për: a) zgjidhjen teknike të propozuar; b) vlerësimin e ndikimit mjedisor; c) vlerësimin e kostos; d) parashikimet ekonomike duke përfshirë mënyrat e financimit të cilat justifikojnë planin e biznesit për projektin e transmetimit të gazit natyror të përgatitura nga një shoqëri e specializuar inxhinierike. Plotësuar. Subjekti bën me dije se vlerësimi mbi koston në mjedis dhe vlerësimi i kostove gjendet në aneksin 2.5. Për sa u përket dispozitave ekonomike duke përfshirë mënyrat financiare që justifikojnë planin e biznesit, referencë pika 6 e nenit 9 (1) (e) sa më sipër dhe Kodin Tarifor TAP në aneksin 4.10.

xvi. Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jeta e pritshme e projektit. Plotësuar. Programi i punimeve të projektit dhe të dhënat e operationeve komerciale janë dhënë bashkëlidhur aneksit 5.6.

xvii. Planet vjetore të investimit për përmirësimin, zgjerimin ose modifikime të tjera të Sistemit të Transmetimit për një periudhë jo më pak se 5 vjet prej datës efektive të licencës në përputhje me legjislacionin në fuqi. Plotësuar. Subjekti ka dhënë sqarimet përkatëse duke referuar në vendimin për përjashtimin e TAP AG nga aksesin e palëve të treta sipas nenit 22 të direktivës së tretë të gazit të BE-së nr. 73/2009, për një periudhë 25-vjeçare. Si të tillë ka konsideruar se kjo kërkesë e rregullores nuk aplikohet për TAP AG.

xviii. Programi i parashikuar i mirëmbajtjes së Sistemit të Transmetimit. Plotësuar. Subjekti ka dhënë informacion në lidhje me marrëveshjet e mirëmbajtjes, planit të mirëmbajtjes së TAP.

- Referuar nenit 5 të rregullores për “Procedurat



dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”; kohëzgjatja e vlefshmërisë së një licence të lëshuar në përputhje me nenin 4 sipas kësaj rregulloreje për ushtrimin e aktivitetit të transmetimit të gazit natyror, do të jetë për një periudhë prej 30 vitesh. Afati i aplikueshëm për TAP AG është i lidhur me vendimin e përjashtimit të aksesit të palëve të treta siç cituar më lart në relacion. Afati ky i caktuar për një periudhë prej 25 vjetësh.

- Licencim i TAP AG ka për qëllim vazhdimësinë normale të punës në tregun e gazit natyror të këtij subjekti. Nga ana tjetër i gjithë procesi i shqyrtimit të këtij aplikimi është kryer në përputhje me “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

- Referuar Opinionit të Përbashkët Përfundimtar (Final Joint Opinion), miratuar me vendimin nr. 64, datë 13.6.2013, të Bordit të ERE-s; dhe miratimit të përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP- AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41(6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline”, miratuar me vendimin nr. 64, datë 13.6.2013, të Bordit të ERE-s “Për amendimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 27, datë 1.3.2013, përcaktohet përjashtimi i sipërcituar për një periudhë prej 25 vjet.

- Subjekti TAP AG ka paraqitur brenda afateve dokumentacionit e kërkuar në bazë të nenit 11 pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, Trans Adriatic Pipeline AG Albania, e regjistruar pranë QKB-së, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), Trans Adriatic Pipeline AG, për një afat 25-vjeçar, nga data e fillimit të operimit.

2. Jo më vonë se 12 muaj nga fillimi i operimit të gazsjellësit, shoqëria të paraqes në ERE dokumentacionin e plotë që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar në territorin e Shqipërisë.

3. Në rastin e mospërmbylljes së këtij kushti nga ana e subjektit, ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi.

4. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR NË DETYRË
Adriatik Bego

VENDIM (i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. 341, datë 1.11.2018, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Sali (Mikel) Spahiu, i datëlindjes 14.4.1976, më 5.5.2005, si dhe caktimin si kujdestare të pasurisë së tij bashkëshorten, shtetasen Imelda Spahiu.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 252 lekë